

UNIVERSITETI I EJL

ЈИЕ УНИВЕРЗИТЕТ

SEEU UNIVERSITY



FAKULTETI I GJUHËVE,
KULTURAVE DHE KOMUNIKIMIT
ФАКУЛТЕТ ЗА ЈАЗИЦИ, КУЛТУРИ И
КОМУНИКАЦИЈА

FACULTY OF LANGUAGES,
CULTURES AND COMMUNICATION

STUDIMET PASDIPLOMIKE-CIKLI I DYTË

ТЕМА:

KANUNI SI INTERTEKST NË ROMANIN “PRILLI I THYER”

Kandidatja:
Egzona Mustafa

Mentorja:
Doc.dr.Meral Veseli

Tetovë 2022

Abstrakt

Me veprën e vet Kadareja e ka njohur lexuesin me kodet që kanë qenë të pashkruara shqiptare e që kanë vepruar në Shqipërinë e Veriut, qëllimi kryesor i autorit kishte qenë që nëpërmjet kësaj vepre letrare të vihet në dritë fuqia që kishte pasur Kanuni i Lekë Dugagjinit te njerëzit e këtyre krahinave. Nëpërmjet ngjarjeve që zhvillohen në romanin “Prilli i thyer”, autori kritikon apo demaskon anët negative të kanunit në shoqërinë shqiptare dhe pasojat që kishte sjellë.

Temat kryesore që shtjellon në roman janë: gjakmarrja, besa dhe nderi, këto dy të fundit janë gurthemeli i një shoqërie të shëndoshë.

Në roman autori na sjell fatin e një malësori të veriut, fat i cili ishte i lidhur me familjen, me fisin dhe për hirë të kësaj lidhjeje gjaku, ai për fat të keq ishte i detyruar t’i zbatojë rregullat e kanunit.

Duke qenë familja e tij në hasmëri, fati i tij ishte i paparëcaktuar që kur kishte ardhur në këtë botë dhe ajo ishte vdekja.

Edhe pse personazhi kryesor, Gjorgu nuk donte që kjo gjakmarrje të vazhdonte dhe më tej, prapëseprapë ai u bë vrasës.

Në një vend ku forca zakonore është pushtet absolut dhe ku kushtetuta dhe ligjet e shtetit nuk përfillen fare , liria e individit është e kufizuar dhe çfarëdo veprimi mban emrin e nderit të ligjeve të pashkruara, siç ishte Kanuni.

Edhe tema e dashurisë që përshkruhet në vepër, na lë të kuptojmë se edhe pse në rrethana të disfavorshme për Dianën dhe Gjorgun, prapëseprapë i lë një hapësirë të vogël për të menduar për jetën, duke lënë anash për një moment vështirësitë e saj.

Апстракт

Со своето дело Кадаре го запозна читателот со шифрите кои биле напишани албански и кои функционираше во северна Албанија, главната цел на авторот била преку ова литературно дело да ја извади на виделина моќта што ја имал Канунот на Лека Дугаѓини во луѓето од овие провинции. Преку настаните што се случуваат во романот „Скршен април“, авторот ги критикува или демаскира негативните страни на канонот во албанското општество и последиците што тој ги донел.

Главните теми за кои зборува во романот се: крвната одмазда, верата и честа, кои последните две се камен-темелник на здравото општество.

Во романот авторот ни ја пренесува судбината на еден северен планинар, судбина која била поврзана со семејството, племето и заради оваа крвна врска, за жал, бил должен да ги следи правилата на канонот.

Бидејќи беше неговото семејство во непријателство, неговата судбина беше неизвесна откако дојде на овој свет и тоа беше смрт.

Иако главниот лик Ѓоргу не сакаше да продолжи оваа крвна одмазда, тој сепак стана убиец.

Во земја каде што обичајната сила е апсолутна моќ и каде што уставот и законите на државата воопшто не се земаат предвид, слободата на поединецот е ограничена и секое дејствие го носи чесното име на напишани закони, како што е Канунот.

Дури и љубовната тема опишана во делото ни дава до знаење дека иако во овие неповолни околности за Дијана и Ѓоргу, сепак остава малку простор за размислување за животот, оставајќи ги за миг настрана неговите тешкотии.

Abstract

With his work Kadare has acquainted the reader with the codes that have been unwritten Albanian and that have operated in northern Albania, the main goal of the author had been through this literary work to bring to light the power that the Kanun of Lekë Dugagjini had in the people of these provinces. Through the events that take place in the novel Broken April, the author criticizes or unmasks the negative sides of the canon in the Albanian society and the consequences it had brought.

The main themes he discusses in the novel are: blood feuds, faith and honor, which the latter two are the cornerstone of a healthy society.

In the novel the author brings us the fate of a northern highlander, a fate which was related to the family, the tribe and for the sake of this blood connection, he was unfortunately obliged to follow the rules of the canon.

Being his family in enmity, his fate was uncertain since he came to this world and it was death.

Although the main character, Gjorgu did not want this blood feud to continue, he nevertheless became a murderer.

In a country where customary force is absolute power and where the constitution and laws of the state are not taken into account at all, the freedom of the individual is restricted and any action bears the honorable name of unwritten laws, such as the Kanun.

Even the theme of love described in the work, lets us know that even though in these unfavorable circumstances for Diana and Gjorgu, it still leaves a little space for thinking about life, leaving aside for a moment its difficulties.

Përmbajtja

Abstrakt.....	2
Анстракт	3
Abstract.....	4
Përmbajtja.....	5
KAPITULLI I PARË.....	7
1. HYRJE.....	7
1.1 I SMAIL KADAREJA– JETA DHE VEPA	8
1.2 ANALIZË E VEPRËS PRILLI I THYER	10
1.2.1 GËRSHETIMI I PERSONALITETEVE NË VEPËR:	16
1.3 KANUNI I LEKË DUKAGJINIT	18
KAPITULLI I DYTË.....	25
2.1 ANALIZË INTERTEKSTUALE E ROMANIT	25
2.1.1 Kult i mikut në shtjellimin e romanit.....	28
2.1.2 VRASJA	29
2.1.3 BESA	30
2.1.4 KËMISHA E PËRGJAKUR.....	32
KAPITULLI I TRETË	34
3.1 JETA PËRMES VËSHTRIMIT NGA VDEKJA.....	34
3.1.1 MENDIMI I GJORGUT PËR TË MOS MARRË GJAKUN.....	36
3.1.2 FUSHAT E PUNUARA DHE TË PAPUNUARA.....	36
3.1.3 TAKIMI RASTËSOR-DASHURIA.....	37
3.1.4 LINDJA E DJALIT	39
3.1.5 VRASJA E FOSHNJËS	40
3.1.6 NJË VRASJE E DËSHTUAR.....	41
3.1.7 PAS VRASJES, ÇFARË MENDOI GJORGU ?	41
3.2. METAMORFOZA E GJORGUT.....	42
3.2.1 METAMORFOZA E DIANËS	42
3.2.2 PRANIMI I REALITETIT	44
3.2.3 PRANIMI I DASHURISË NGA GJORGU.....	44
3.2.4 TRADITA PËR VRASJE.....	45
3.2.5 PAJTIMI MES KËTYRE DY FAMILJEVE.....	45
3.2.6 KAU I ZI.....	46
3.2.7 GJAKMARRJA PJESE E JETËS SË SHQIPATËRVE.....	46
3.2.8 THYERJA E RREGULLIT TË KANUNIT– DIANA.....	48

KAPITULLI I KATËRTË	49
4.1 ÇFARË EKZISTENCIALIZMI FUNKSIONON NË RRAFSH	50
4.1.1 DIANA NË KULLËN E NGUJIMIT	51
4.1.2 SI NDIHET BESIANI NË RRAFSH	52
4.1.3 SI KISHTE NDODHUR GJAKËMARRJA MES KËTYRE FAMILJEVE	53
4.1.4 VDEKJA E NATYRSHME NË RRAFSH.....	54
4.1.5 GJORGU DHE DIANA NJË NGJYRË NDRYSHË E KËTIJË ROMANI	54
4.2 GJUHA DHE RËNDËSIA E KËSAJ VEPRE NË LETËRSINË SHQIPTARE	55
KAPITULLI I PESTË.....	57
5. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	57
Bibliografia	60

KAPITULLI I PARË

1. HYRJE

Siç e dimë, e gjithë letërsia shqiptare është e lidhur me emrin dhe veprat e shkrimtarit të njohur, Ismail Kadare. Tema e cila do të shtjellohet në këtë punim është për romanin “Prilli i thyer” dhe “Kanunin e Lekë Dukagjinit”. Ndërlidhja që kanë këto dy vepra letrare mes veti, apo siç njihet kjo lëndë intertekstualiteti, pra Kanuni si intertekst të “Prilli i thyer”.

Qëllimi i punimit është që të gjenden lidhjet në mes këtyre dy veprave dhe ngjajshmërinë që kanë mes veti.

“Prilli i thyer” është vepër mjaft interesante e Ismail Kadaresë. Në këtë vepër letrare autori ka përshkruar tamam shqiptarinë se si është apo si ka qenë më herët. E paraqet shqiptarin, të besës, të mikpritjes dhe të sjellshëm. Temat kryesore që i ka ky roman janë: besa, gjakmarrja dhe nderi.

Që në krye të saj vepra hapet me gjakmarrjen, autori e fillon me personazhin e Gjorgut, cili është i detyruar të marrë hakun e vëllait të vranë nga familja e Kryeqyqëve. Kjo vrasje duhet të bëhet sipas traditës së Kanunit edhe pse Gjorgu nuk ishte i këtij mendimi.

Familjet që ishin në gjak mes veti ishin familja e Kryeqyqëve dhe Berishajve. Pjesa kryesore e romanit zhvillohet në një fshat të Malësisë së Veriut. Aty ku kanuni ka qenë dominant gjithmonë. Përveç ngjarjeve që zhvillohen për marrjen e gjakut, aty dominon në një pjesë edhe dashuria, pra siç është dashuria në shikim të pare mes Dianës dhe Gjorgut, dashuri që rrezikon dhe jetët e tyre. Udhëtimi i Dianës me Besian Vorpsin në Malësi, në Kullën e Oroshit.

Kanuni është libër mjaft interesant sepse aty simbolizohet jeta shqiptare me doket dhe zakonet e veta. Në kanun temat kryesore janë: besa, gjakmarrja dhe nderi, pra e kemi theksuar edhe më lartë se këto tema janë të përdorura dhe në romanin e Kadaresë. Autor i kanunit është At Shtjefan Gjeçovi.

Kanuni në veri të Shqipërisë njihet si “Kanuni i Lekë Dugagjinit”, kjo vepër është kryevepra e kombit shqiptarë të të gjitha kohërave. Në kanun flitet se si duhet të merret gjaku, se si jepet besa për vrasësin, si pritët miku, etj. Në bazë të këtyre temave shihet ndërlidhja e “Prillit të thyer” në “Kanunin e Lekë Dukagjinit”.

Çdo vepër letrare mund të ketë intertekst me një vepër tjetër.

1.1 I SMAIL KADARE– JETA DHE VEPRAT

Letërsia shqiptare është e pasur me shkrimtarë, të cilët me veprat e tyre e kanë pasuruar letërsinë shqipe jo vetëm brenda vendit, por dhe në arenën ndërkombëtare. Disa nga këta shkrimtarë janë bërë të njohur në botë, nga veprat e të cilëve dhe bota njohu kulturën e popullit shqiptar. Njëri ndër ta është edhe autori në fjalë, Ismail Kadare. Mund të themi që ky autor solli një ndryshim në letërsinë shqiptare. Kur themi ndryshim është fjala se me veprat e tij, letërsia shqiptare mori fizionomi tjetër. Kadareja është shkrimtari i parë shqiptar që është i njohur dhe në arenën ndërkombëtare.

“Ismail Kadare është shkrimtari më i mirë i letërsisë shqipe, ndër shkrimtarët më të mirë të letërsisë botërore bashkëkohore, dhe autori më i përkthyer jashtë vendit, fitues i disa çmimeve letrare ndërkombëtare dhe i nominuar me dhjetëra herë për çmimin Nobel” (Kadare, 2022).

“Ismail Kadare ka lindur më 28 janar të vitit 1936, në Gjirokastrë” (Ismail Kadare, 2022) në një familje qytetare. Kadaresë, emrin ia vunë të gjyshit, pra e trashëgoi. Prindërit e Kadaresë, përveç këtij fëmije patën edhe dy fëmijë të tjerë.

Shkollën fillore dhe të mesme e ndoqi në qytetin e tij të lindjes, në Gjirokastrë. Ai, si fëmijë kishte qenë mjaft i aftë në shkollë.

“Kur ishte 13 vjeç zbuloi Makbethin, një ndër veprat e Uiliam Shekspirit, dhe kështu i lindi dashuria për letërsinë.” (takim, 2022). *“Në këtë moshë shkroi tregimet e para të cilat i botoi te revista "Pionieri" në Tiranë.”* (takim, 2022). *Në moshën 17 vjeçare shkroi dy poezi për Stalinin, gjë që sipas Malcolm, ndihmoi në botimin e librit të tij të parë në moshën 18 vjeçare, një përmbledhje poetike e quajtur Frymëzime djaloshare.”* (Gjeniu, 2022).

Studimet i kreu në Universitetin e Tiranës. Atje mbaroi për Gjuhë dhe Letërsi në vitin 1958.

Jeta e autorit kishte qenë e lidhur me Shqipërinë dhe Rusinë, ku edhe atje kishte bërë studime pasuniversitare. Një pjesë të jetës e kaloi në Rusi, por nga një mosmarrëveshje mes Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik, ai ishte kthyer në Shqipëri.

Jeta e Kadaresë nuk ka qenë e lehtë për gjatë studimeve, sepse ai jetonte larg familjes së tij.

“Kadareja është martuar me shkrimtaren, Helena Kadare, dhe kanë dy vajza.” (Kadare , 2022).

Ai asnjëherë nuk e la anash jetën personale, ku nga kjo martesë ka dhe fëmijë dhe mund të quhet se ka një jetë të kompletuar, si nga ana artistike ashtu edhe ajo personale.

Krijimtarinë letrare si poet e ka nisur në shkollë, me :

“Frymëzimet djaloshare, 1954, "Ëndërrimet", (1957), por u bë i njohur sidomos me vëllimin *Shekulli im* (1961), që u pasua nga vëllimet e tjera poetike, si: *Përse mendohen këto male* (1964), *Motive me diell* (1968) dhe *Koha* (1976).” (Antoena, 2022).

Nga përkthimet e veprave të Kadaresë, Shqipëria u njoh nga të gjithë popujt tjerë.

“Ndër veprat më të njohura të Kadaresë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar janë: *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, *Kështjella*, *Kronikë në gur*, *Ura me tri harqe*, *Kush e solli Doruntinën*, *Prilli i thyer*, *Dosja H*, *Pallati i ëndrrave*, *Piramida*, *Pasardhësi*.” (Jeta dhe vepra e I. K., 2022).

Veprat e tij kryesisht kishin për temë jetën e popullit të tij. Vështirësitë që i kishte kaluar populli shqiptar, ai i trajtonte në veprat e veta. Me ngjarjet që i trajtonte në veprat e tij, lexuesin e bënte për vete.

Në vendin ku jetoj dhe krijoi pas viteve të '90, Kadareja bëri që populli shqiptar të ndihet krenar me veprat e tij dhe me të.

“Në gjuhë të huaj shumica e veprave të Ismail Kadaresë janë përkthyer e botuar në mbi 45 gjuhë të botës dhe janë pritur shumë mirë nga publiku lexues. Ai është shkrimtari shqiptar më i njohur në botë.” (Antoena, 2022).

Kadareja kryesisht është marrë me prozë, por krijoi edhe në poezi. Proza ka qenë pjesë e frymëzimit për veprat e tij.

Ismail Kadare ka qenë i njohur në mbarë arenën botërore për letërsi.

“Njohja dhe vlerësimi ndërkombëtar” (Kadare, f. e autorit, 2022)

“Ismail Kadare është laureat i shumë çmimeve letrare kombëtare dhe ndërkombëtare” (I.K., 2022).

“Në vitin 1996 Kadareja u bë anëtar për jetë i Akademisë së Shkencave Morale dhe Politike në Francë” (wikipedia, 2022).

Jeta e Kadaresë, tani më kishte ndryshuar përveç Ruisë dhe Shqipërisë ai kishte kaluar një pjesë të jetës edhe në Francë. Ku atje u angazhua menjëherë në punë.

“Në vitin 1992 u vlerësua me Prix Mondial Cino Del Duca; në 2005 fitoi "Man Booker International Prize" dhe në vitin 2009 u nderua me çmimin spanjoll Prince of Asturias, për Artet - që është një nga çmimet letrare më prestigjioze në botë” (Kadare, f. e autorit, 2022).

Çmimet që i merrte nuk ishin vetëm në vendet ku kishte jetuar, ai i merrte edhe nga vendet tjera, ashtu siç është cekur që ka fituar çmimin në Spanjë, Itali, etj.

“Në vitin 2010 Ismail Kadareja nderohet në Itali me çmimin Lerici Pea” (wikipedia, 2022).

“ Qëllimi i çmimit është promovimi i poezisë, në veçanti i poetëve të rinj, eksperimentimi i gjuhëve të reja poetike dhe njohja e poetëve të mëdhenj” (Kadare, faqja e autorit, 2022).

Edhe pse e kishte prozën frymëzim primar, ai anjëherë nuk e lë anash poezinë, ku edhe aty mori çmime.

Kadareja nuk është vlerësuar vetëm nga të huajt, ai ka marrë dekorata edhe nga përfaqësuesit e institucioneve shqiptare.

“Ismail Kadare është dekoruar nga institucioni i Presidentit të Republikës së Shqipërisë me Urdhrin “Nderi i Kombit” dhe nga shteti francez me urdhrat “Kryqi i Legjionit të Nderit” e “Oficer i Legjionit të Nderit” (wikipedia, 2022).

1.2 ANALIZË E VEPRËS PRILLI I THYER

Romani “Prilli i thyer” fillon në mënyrën mjaft të rëndë. Në fillim të romanit flitet për gjakmarrjet, por pjesa e fundit është me një dashuri. Personazhi i cili duhet ta marrë hakun për vëllanë është një djali i ri ,vetëm 26 vjeç. Rinia e të cilit do t’i shkojë në dëm, sepse nëse ai ka marrë gjakun e të vëllait, atëherë ai do të ngujohet në shtëpi, sepse gjaku shkon me gjak. Emri i veprës “Prilli i thyer” mendohet që më 17 prill Gjorgut i skadonte besa tridhjetëditëshe, dhe për këtë arsye ka marrë emrin, poashtu prilli tregon fillimin e pranverës. Gjorgu është 26 vjeç, kur nxorri gjakun për të vëllanë, për atë jeta e tij mori një drejtim tjetër. Nga jeta rinore e një djali të ri, Gjorgu tani njihet si vrasës.

Për Gjorgun ishte e rëndë çdo ditë që vinte kur e shikonte ashtu babain e tij, se ai gjithnjë ia kujtonte të vëllanë. Ai, jo që e kishte lënë anash këtë punë, por për të ishte e

vështirë të bëhej vrasës. Përveç kësaj për Gjogun ishte e papërballueshme kur e shihte këmishën e të vëllait të varur në katin e sipërm të shtëpisë. Një ditë, një nga ato ditët më të tmerrshme për Gjogun erdhi, ishte dita e 17 marsit aty ai mori gjakun për të vëllanë. Për atë kishte filluar një etapë e rëndësishme dhe vendimtare për jetën. Kjo kishte qenë hera e dytë që Gjorgu shtiu mbi familjen e Kryeqyqëve, të parën herë kishte dështuar. Në të gjithë fshatin u mor vesh që Gjogu i Berishajve, shtiu mbi Zef Kryeqyqën. Gjorgu, pasi vrau gjakësin, vendosi pushkën sipas rregullave të kanunit, pranë kokës dhe u kthye për në shtëpi. Kur arriti në shtëpi, duart i kishte të gjakosura dhe babai e kuptoi se e kishte vrrarë gjakësin.

Për Gjogun, të nesërmen filloi një ditë e re, kur u zgjua e pa se nëna e kishte larë këmishën e të vëllait. Gjakmarrja midis familjeve, Berishajve dhe Kryeqyqëve kishte filluar shumë më herët se këto vrasje. Kishte ardhur një herë një i panjohur në shtëpinë e Berishajve, e kishte zënë mbrëmja dhe kishte kaluar natën si mik aty, në shtëpinë e tyre. Sipas zakonit miku duhet të përcillet deri aty ku ishte hapësira që miku të ruhet, por aty krisi pushka. *“Në qoftë se zoti i shtëpisë e përcjell mikun dhe i kthen shpinën, në atë çast ndodh se miku u vra, ti je i lirë nga gjakësi”* (Ese, 2022). Përcjellësi kishte kthyer shpinën kur ishte vrrarë miku, por këtë nuk e kishte parë askush. Gjaku u rëndonte Berishajve, sipas komisionit. Po atë ditë u mor vesh kush kishte shtënë mbi të panjohurin. Ishte një djalë i Kryeqyqëve. Kështu filloi gjakmarrja mes këtyre familjeve.

Kur të kryhen të gjitha ritualet, Gjorgu duhet të shkojë e ta paguajë tagrun e mortit. Derisa ishte nisur të shkonte e të paguante targun e mortiti, Gjorgu ndjeu njëfarë frike se si do shkonte deri te kulla e Oroshit. Ai mendonte se vetëm sa të mbërijë aty, të paguante tagrun, por jo, aty duhet të priset, se ka dhe shumë të tjerë që presin ta paguajnë.

Ngjarjet të cilat rrëfohen autori kanë ndodhur në veri të Shqipërisë, gjegjësisht në Mirditë. Përveç që Gjorgu përshkruhet si një vrasës, autori në këtë roman përshkruan udhëtimin e bashkëshortëve Vorpsi në Rrafsh. Diana dhe Besiani ishin dy të martuar që kishin ardhur për muajin e mjaltit në Malësinë e Shqipërisë. Besiani ishte gazetar i njohur, ndërsa Diana vajzë kryeqyteti. Duke shkuar në atë pjesë të Shqipërisë, Diana shikonte njerëzit se si kishin një lloj shikimi skeptik, të mllëfosur. Kur arritën në Malësi, Diana dhe Besiani vetëm vëzhgonin, poashtu ishin dhe të shqetësuar me pamjet dhe ngjarjet aty që shihnin. Të dy ishin të shqetësuar, aty pranë kaluan disa dasmorë, kishte plot gra të veshura me kostume të bukura. Besiani i tregonte të shoqes se edhe dasmat në këtë pjesë të Shqipërisë bëhen sipas kanunit. Ai i tregonte Dianës se këtu asnjëherë nuk ndërpritet dasma edhe nëse ka njeri të vdekur, edhe nusja që merrej edhe po të jetë e sëmure, ajo duhet të

shkojë me krushqit në shtëpinë e burrit. Udhëtimi i tyre u bë interesant me historit që ia tregonte Besiani për Rrafshin, ngjarjet nga më të ndryshmet. Për Dianën këto ishin me rëndësi, sepse për herë të parë po dëgjonte rreth këtyre historive dhe ngjarjeve.

Bashkëshortët Vorpsi ishin të ftuar në kullën e Oroshit, por ata u ndalën me karrocë . Besiani e pyeti: Edhe sa kemi deri te kulla e Oroshit?- karrocieri i ktheu përgjigjen: edhe 5-6 orë deri atje. Ata u ndalën që të pushonin në një bujtinë. Në atë bujtinë njerëzit ishin kureshtarë për çdo gjë që nodhte, poashtu dhe për Dianën. Posa hynë në bujtinë, bujtinari i tregonte për Binak Alinë, por Besiani nuk e njihte. Bujtinari kishte një admirim të madh për gjyqtarin dhe fliste me ëndje për atë. Kur Diana dhe Besiani ishin ulur, aty afër erdhën disa burra dhe shikojnë sesi njëri jepte urdhëra. Takimi i Binak Alisë me Besianin dhe Dianën kishte qenë krejtë rastësor. Kur Binak Alia ishte duke u dhënë urdhëra disa malësorëve, aty afër afrohet Besiani, prezentohet me të, por malësorët mbetën të habitur se si nuk e njeh Binak Alinë. Diana dhe Besiani deri sa udhëtimin e tyre e vazhdonin, ata takuan shumë njerzë që janë të atyre fshatrave përreth. Po nga këta shumë njerëz që panë aty, Diana pa edhe Gjorgun, një malësor të ri, i cili i ra në sy sepse kishte në mëngë rub të zi, ajo se kuptonte për çfarë arsye e ka atë dhe pyeti Besianin. Ai iu përgjigj me zë të ultë se ky është dorasi. Karroca e bashkëshortëve Vorpsi ishte aty pranë, nga kureshtja Besiani e pyeti si quhesh? Ai iu përgjigj menjëherë. Gjorg. Ata gjatë udhëtimit bisedonin për Gjorgun, se ishte i zbehur, se si e kishte bërë vrasjen para disa ditëve. Besiani ia tregonte të shoqes gjitha zakonet kanunore, si këmisha e viktimës rri e varur deri sa gjaku të merret. Kur këto histori i dëgjonte Diana, ajo mendonte dhe dëgjonte me vëmendje dhe e mendonte Binak Alinë, se si ecën katund më katund, po ashtu e mendonte edhe djalin e ri, Gjorgun. Ajo më herët kishte dëgjuar se kur i kalon besa dorasit, ai duhet të rri i ngjuar në kullë. Njërin prej tyre tani e mendonte malësorin e ri, se dhe këtij mund t'i ndodhë ashtu, ndjeu keqardhje për atë, por dhe një ëmbëlsi për dikë që kurrë më herët nuk i kishte ndodhur. Ishte hera e parë prej se ishte me Besianin që mendonte për dikë lirshëm. Nuk ishte ndier asnjëherë e tronditur nga një vështrim burri, vetëm në rastin e Gjorgut.

Udhëtimi për në kullën e Oroshit u bë shumë i gjatë. Kjo kullë ndryshe njihej edhe si Kulla e Princit. Këtë përshkrim ia kishte thënë Besiani të shoqes dhe ajo pyeste se çfarë lidhje mund të kenë mes veti familja mbretërore me atë princit. Ajo dëshironte të dinte diçka “*më shumë, por Besiani ia dha mënyrën se si është, familja e kullës së Oroshit është më e vjetër se familja mbretërore, për mënyrën se si ajo sundon në Rrafsh*” (fjalori, 2022). Ai i shprjegonte të shoqës se ky lloj sundimi është i veçantë, sepse kanuni nuk ngjason me askënd.

Ai i tregonte Dianës se në këtë krahinë asnjë nga pushtetet nuk ka mundur të futet asnjëherë. Gjatë udhëtimit të tyre ata patën mjaft biseda interesante rreth Rrafshit, kanunit, fshatrave etj. Koha e mbërritjes në kullë ishte një lehtësim, po nga pritja e njerëzve aty ata nuk ndien një ndjesi të mirë.

Arritën në kullë, u rehatuan, e shoqja po shikonte te dritarja dhe aty vërejti një dritë, pyeti të shoqin se çfarë është ajo dritë?- ia ktheu Besiani që kjo është kthina e famshme e gjakësit për të bërë pagesën. Diana përsëri pyeti se a mund të jetë ai aty, e kishte fjalën për Gjorgun. E gjithë nata ju kishte kaluar duke biseduar e duke menduar, ajo mendonte se si nëpër atë ferr kishte kaluar dhe Gjorgu të cilin e quante “Princi im i zi”.

Kulla e Oroshit ka pasur një vend të posaçëm në këtë roman. Mark Ukaçjerra ishte njeriu që merrte pjesën e gjakmarrjes. Ai ndryshe quhej” qehaja i gjakut”. Ai pos që kishte çëshjten kryesore atë të gjakut, ai kishte dhe nën mbikqyrje arkivën e kullës. Arkiva e kullës gjendej në bibliotekë, por Mark Ukaçjerra e urrente bibliotekën dhe librat që ishin aty, sepse aty kishte libra të shkruar e gojëdhëna për Rrafshin. Mysafirët vizituan dhe bibliotekën, por Marku nuk ishte i kënaqur sepse nuk e donte gazetarin se ai kishte shkruar një shkrim për Rrafshin, por sipas tij s’merret vesh gjë. Në bibliotekë ishte një libër, të cilin e mbante vetëm Marku i cili u quajt “Libri i gjaqeve”. Aty ishin të shkruara të gjitha gjakmarrjet dhe ndonjë borxh që i kishin mbetur. Kur i vinte ndokush, e që ndodhte shumë rrallë, aty ai shihte si si po bie numri i gjakmarrjeve ndër vite. Përveç kësaj Marku ishte dhe kundër princit se si mbrëmë ishte që vetëm ai mbajti fjalën, që kurrë më parë si kishte ndodhur, ai ishte pro kanunit që femra mos të futet në kullë. Ajo jo vetëm që ishte futur në kullë, por edhe në dhomën e miqve. E përqueshte princin se si u dorëzua para një gruaje. Gjatë një bisede e sipër me kryezotin e kishës ata biseduan se si disa njerëz kërkojnë zbutjen e kanunit. Kanuni në gjak shpallte vetëm gjininë mashkullore, pos priftërinjëve nuk quheshin të rënë në gjak edhe gratë. Në mendimet e Mark Ukaçjerrës ishin se gjithmonë dasmat bëhen në mënyrë të hareshme, pa e menduar fare gjakmarrjen. Ai bënte krahasimin e gjaqeve të reja me ato të vjetra, se gjaqet e reja ishin të shpejta dhe të vrullshme, ndërsa ato të vjetra të ngadalta dhe të ftohta.

Tokat e Rrafshit njiheshin prej së largu, se cila ishte në gjak e cila nuk ishte, ato që ishin të punuara, ato kishin për të marrë gjak, ndërsa ato të papunuara, pra ata ishin të ngujuar në kullë dhe nuk mund të dilnin të punonin, tokat mbeteshin djerr. Por, kjo pasqyrë e tokave ndryshonte nga momenti që gjaksi merrte gjakun dhe toka mbetej e papunuar, ndërsa ajo që ishte djerrinë fillon të lulëzojë.

Të gjitha këto që ndodhën për Markun kishin rëndësi, sepse ai fillonte të mendonte për të gjitha ndodhit, prej kohës kur ishte bërë qehajai i gjakut. Shumë shpesh e pyeste vetën mos po më zenë gjaku. Por, kjo punë e qehajave u kishte ndodhur shumicës, i zinte gjaku pa pasur gjak.

Gjorgu në Brezftoht u kthye më 25 mars. Kthimi iu duk i shkurtër, por gjatë gjithë kohës ishte si i përgjumër. Në shtëpi kur u kthye e ndjeu një ngrohtësi. Gjatë gjithë kohës e ndiente vetën të lodhur. Deri sa kalonte nëpër oborrin e shtëpisë ai e ndiente vetën të pasigurt. Mendimi i tij i vetëm ishte se çdo ditë e më afër e kishte vdekjen. Për ta larguar këtë mendim ai dëshironte që të largohet nga fshati si shumë fshatarë të tjerë që janë larguar. Pasi që iu kishet afruar dita e besës, Gjorgu kërkoi nga babai i tij që këto dy javë jetë që i kanë mbetur të shetisë nëpër bjeshkë.

Udhëtimi i tij ishte herë i gjatë e herë i shkurtër. Në këtë udhëtim takonte njerëz të shumtë, por ai gjithmonë rrinte si i tërhequr nga të tjerët. Në një bujtinë ku kishte mbetur i quajtur Hani i Ri, dëgjoji të flitet për karrocën me kadife të zezë dhe për atë femër të bukur. Mendja e Gjorgut, gjithmonë kishte në kujtesë atë grua të bukur me flokë si gështenjë. Për atë kjo bisedë ishte e pakëndshme. Gjorgu tanimë çdo ditë filloi ta kërkonte karrocën me kadife të zezë edhe pse shumë shpesh binte në gjurmët e saj, por humbiste.

Ai jetonte me shpresën se do ta takojë Dianën, e cila endej nëpër Rrafsh, edhe ajo për ta takuar edhe njëherë Gjorgun.

Në këtë pjesë të romanit autori përshkruan bashkëshortët Vorpsi se si vështronin shtegtimin.

Besiani e shikonte gruan e tij të mërziur dhe të lodhur, shumë herë ishte penduar se përse e kishte marrë këtë iniciativë që të vinin ta vizitonin këtë pjesë të Malësisë. Ai priste çdo ditë nga gruaja e tij që t'i thoshte se përse kanë ardhur, por asnjëherë ajo nuk ia tha këtë gazetarit? Ai dëshironte që shumë pyetje t'ia bënte gruas së tij, por diçka e ndalonte. Deri sa ata udhëtonin nëpër rrugën e Rrafshit, karroca ndalet aty afër, pranë një plake, e cila ishte e sëmurë. Ajo kishte një kohë të gjatë që priste aty, por aty s'kalonte asnjëri se fshati kishte hasmëri në mes veti dhe vështirë ishte të kalonte ndonjë mashkull në atë rrugë. Posa hipi plaka në karrocë, filloi të tregonte se cila familje me cilën janë në gjak në mes veti. Plakën e lanë afër shtëpisë dhe vazhduan rrugëtimin me karrocë nëpër fshatra të tjerë. Kur arritën te fshati afër, ata u ndalën të kalojnë natën në një kullë të zakonshme, jo si ato tjerat. Në këtë bujtinë ata ndjenë mirësjellje nga njerëzit që u afruan ndihmë.

Pasi u vendosën, nga dritarja e shtëpisë se ku rrinin panë një pamje të mahnitshme dhe dëshiruan që të shkojnë t'i bëjnë një vizitë, ata zbritën te bujtinari dhe i thanë, që panë një pamje të mahnitshme, bujtinari i tha se ato janë liqenet alpine të Ujvarës së Epërme, mund të shkoni t'i vizitoni. Ata këtë ide e pëlqyen dhe shkuan ta vizitojnë, aty panë një pamje mjaft të mirë, por aty takuan edhe Binak Alinë me gjeometrin dhe mjekun. Binak Alia i pyeti se, ju ende gjendeni në Rrafsh?- Besiani i thotë se dhe disa ditë do të jemi këtu pari. Ata kishin pasur një rast të veçantë nga të tjerët. Ngjarja kishte ndodhur në atë katund, ishte e pazakontë dhe Binak Alinë e kishin ftuar si ndërmjetës. Ajo ishte një vajzë e mbytur nga familja e saj, e cila kishte mbetur shtatzënë jashtëmartese. Sipas familjes së djalit foshnja ishte djalë dhe sipas kanunit në qoftëse në barkun e nënës ishte fëmija djalë, atëherë kërkonin gjak për atë. Pasi këto dy familje nuk mund të gjenin gjuhën e përbashkët mes veti, ftuan pleqësinë e katundit që të marrin mendim. Familja e djalit donin që ta dinin arsyen se pse u bë ajo vrasje, babai i djalit pyeste Binak Alinë se pse miellin e derdhën dhe Binak Alia ia kthen, po mielli yt çfarë deshi në thes të huaj? Pasi që djali ishte pa kurorë me vajzën e huaj dhe kështu të dyja palët u quajtën të lame.

Biseda e mjekut dhe Besianit kishte marrë pamje ndryshe, ishte një bisedë e rëndomtë sikur të ishte në një pjesë ndryshe nga ajo e Rrafshit. Ai e pyeste për punën që bënte mjeku këtu, ku e kishte kryer shkollën etj. Derisa bisedimi i tyre u thellua shumë, Diana për një moment kishte humbur. Diana tanimë gjendej në kullën e ngujimit aty ku askush nuk guxonte të shkonte. Filluan ta kërkonin Dianën, Besiani dhe mjeku, po kot ajo ishte futur në kullë. Aty nuk e lejonin të hynte Besiani, se do ta mbytnin. Duke biseduar fshatarët në mes veti si ta marrin Dianën nga bujtina. Ajo doli, ishte e verdhë, s' mund të njihet kësaj herë është gazetari ai e cili e kapi nga krahu me egërsi dhe e pyet se përse hyri në kullë. Diana dhe Besiani hipën në karrocë dhe nuk folën asnjë fjalë nëmes veti. Udhëtimit të tyre po i vinte fundi dhe së shpejti dhe do të largohen nga Rrafshi. Bashkëshortët Vorpsi filluan rrugën për në shtëpi, po Besiani për të disatën herë ishte zhgënjyer që e kishte sjellë Dianën këtu.

17 prilli “Gjorgun e zuri në Udhën e madhe, që të çonte në Brezftoht” (fjalor i gjuhës shqipe, a.d.). Në mesditë, Gjorgut do t'i mbarojë besa. Ai ende e kërkonte karrocën e zezë, e cila asnjëherë nuk iu kishte larguar nga koka. Për Gjorgun udhëtimi ishte i vështirë, tani që nuk kishte besë duhet të udhëtonte ato rrugë që kanë besë që të mos ndeshet me gjakësin. Gjatë këtijë udhëtimi Gjorgu pati disa takime të rastësishme me disa malësor, të cilëve poashtu u kishe kaluar besa. Në çdo bisedë që bënte me të panjohuriti pyeste për bashkëshortët Vorpsi, në mënyrë indirekte.

Gjorgju ishte dashuruar në vajzën e bukur të kryeqytetit, e cila u quajt Diana, poashtu dhe ajo kishte dashuri për malësorin e ri të cilin e quajti “princi im i zi”.

“Për studiuesen Edlira Birko, vlera e Ismail Kadaresë qëndron pikërisht tek dhënia jetë e kësaj gjendjeje të ndërmjetme, e cila është gjendje natyrore e vetë njerëzores” (Vepra e Kadaresë, 2022).

“Studiuesi Hoxha e sheh “Prillin e thyer” si një terren ku Kadareja përthyen dy narrativat botërore, atë individuale dhe atë botërore” (Vepra e Kadaresë, 2022).

“Studiuesi Hoxha e sheh “Prillin e thyer” si një terren ku Kadareja përthyen dy narrativat botërore, atë individuale dhe atë botërore” (Vepra e Kadaresë, 2022). *“Për të, narrativa e parë na vjen në formën e fatalitetit të Gjogut, kur autori thotë se “Motivimi i njeriut brenda fatit, apo në përshkallëzim të të drejtës nëpër shtresat e rendit shoqëror, janë një përvijim i jetës brenda fatalitetit të të jetuarit nën zonën e vdekjes”* (Vepra e Kadaresë, 2022).

“Kritiku letrar amerikan, Herbert Mitgang, në gazetën “New York Times”, për romanin në fjalë ka thënë: “Me “Prilli i thyer”, Kadare vjen në pararojë si romancieri më i madh ndërkombëtar” (“Prilli i thyer”, 2022).

“Ndërkaq, gazeta suedeze “Helsingborgs Dagblad”, në janar të vitit 2015 për Ismail Kadarenë ka shkruar: “Ismail Kadare është Kafka shqiptar” (pasqyra, 2022).

Kritiku letrar dhe studiuesi Ali Aliu në lidhje me romanin “Prilli i thyer” shprehet kështu: *“Ismail Kadare ballafaqohet me refleksat e brendshme të shqiptarit, në mbrojtje të identitetit të tij dhe pasojat që dalin nga fenomeni i gjakmarrjes”* (Miti b., 2022).

1.2.1 GËRSHETIMI I PERSONALITETEVE NË VEPËR:

Personaliteti, personazhi i Gjogut

Gjorgju ishte një djalë i ri, mosha e tij ishte 26 vjeç. Familja e tij ishin në gjak. Në atë familje kishte 44 vdekje, familja e Gjogut u quajt Berishaj, ndërsa familja e gjakësit Kryeqyqët. Detyra e atij ishte që ta merrte gjakun e të vëllait, sipas kanunit. Ai kishte qenë i fejuar, por as të fejuarën nuk e kishte njohur, ajo kishte vdekur. Për Gjogjun ishte një jetë e vështirë në ditët e rinisë, në moshën kur atij i duhej që të jetë i martuar e ta jetoj jetën, për atë jeta kishte marrë tjetër kuptim. Brenga më e madhe e tij ishte se patjetër duhet marrë gjakun, nuk ishte se ai e dëshirtonte gjakëmarrjen, por babai i cili çdo ditë që zgjohej e shikonte me një shikim ndryshe dhe e porosiste që mos ta harronte detyrën që ka.

Njëra nga ato ditët e zeza për Gjorgun u bë dita e 17 marsit, atë ditë kur jeta e atij mori një kthesë ndryshe se nga çka e mendonte, tani më u bë një vrasës. Deri në momentin që e kishte vrarë gjakësin ai e kishte jetuar jetën si një fëmijë, pa brenga.

Për Gjorgun tani ndryshoi çdo gjë. Ai duhet që të i vrari të jetë prezentë gjatë kohës së varrimit, sipas kanunit sepse kishte besën njëzetekatërorëshe orëshe. Ajo ditë për atë ishte e rëndë, të nesërmën u zgjua nga gjumi dhe te dera e shtëpisë e priste babai i tij, i cili ia dha taksën e pagesës së vrasjes që duhet të shkojë ta bëjë te kulla e Oroshit. Gjorgu mendonte se shumë shpejt do të kryhet dhe kjo ceremoni e pagesës, por nuk ishte ashtu sepse aty nuk i dihet sa duhet të pritët për të bërë pagesën. Udhëtimi për në atë vend për Gjorgun ishte pak i vështirë, por me takimin që e pati me zotëri Besian Vorpsin dhe të shoqën, për atë jeta mori tjetër kuptim tjetër. Në tërë udhëtimin që e bëri Gjorgu, mendimet ishin vetëm te bukuroshja Diana dhe ditët e numëruara. Synimi i Gjorgut ishte që ta kenin një jetë të qetë.

Personazhet Diana dhe Besian Vorpsi

Diana dhe Besiani janë një çift i sapomartuar, këta vijnë për ta kaluar mujin e mjaltit në malësinë e Shqipërisë. Ata ishin një çift nga kryqyteti, Besiani ishte gazetar me profesion. Besiani përafërsisht kishte njohuri rreth zakoneve kanunore dhe si rrjedhte jeta në këtë pjesë të malësisë. Ndërsa Diana nuk kishte njohuri dhe as se dinte se çfarë ka për të parë e dëgjuar atje. Kjo ide ishte e Besianin për t'ia bërë një vizitë Rrafshit. Diana ishte kureshtare në çdo gjë që ndëgjonte e shikonte në Rrafsh. Ndërsa, Besiani ishte ai që çdo herë i kthente përgjigje me mençuri.

Personazhi -Binak Alia

Ka qenë njeriu i cili ka marrë pjesë në të gjitha gjaqet. Ai në shikim të parë ka pasur pamjen që të ka lënë mbresa të këqija, por ka qenë njeri pozitiv. Siç shkruan në roman ai ka jetuar në malësinë e Gjakovës, por ka marrë pjesë edhe në Lidhjen e Prizrenit. Binak Aliu ka qenë i njohur për pajtimin e njerëzve.

Personazhi- Mark Ukaçjerra

Mark Ukaçjerra ka qenë njeriu i cili ka marrë taksën e pagimit nga vrasësi. Kishte qenë njeriu i cili ishte i etur për para, kishte dëshirë që të kishte sa më shumë vrasje. Por dhe nga sjelljet ka qenë një njeri i vrazhdë.

1.3 KANUNI I LEKË DUKAGJINIT

Siç dihet Kanuni i Lekë Dugagjinit është një libër me vlera dhe është një libër unik. Ky kanun më shumë ishte i rrespektuar në territorin e Rrafshit. Populli shqiptarë njihet për zakonet e tyre në botë nga ky libër.

“Kanuni është ndër ligjet më të vjetra të Evropës” (f gjokaj, 2022). *“Ky kanun është përmbledhje e normave dhe dokeve shqiptare, ligjet e tij kanë shërbyer për një kohë të gjatë si norma shoqërore dhe si një sistem vetqeverisës që mbizotëronte në viset e malësive të Shqipërisë së Veriut”* (kanuni, 2022).

Kanuni i Lekë Dugagjinit ishte më i përhapur në territorin e Shqipërisë së Veriut, aty ku shteti nuk kishte forcë të futet e të pranohen rregullat e shtetit, përveç kanunit.

“Kanuni i Lekë Dukagjinit ka një rëndësi themelore në historinë e popullit shqiptar pasi që është një dokument i lashtë” (p. e normave, 2022). *“Forma e parë e shkruar e kanunit i referohet Lekë Dukagjinit edhe pse flitet të ketë ekzistuar edhe me parë e që i përkiste gojëdhënave të popullit”* (Kanuni I L. D., 2021). *“Ky kanun vlente shumë për mbrojtjen e pronës, nderit dhe jetës”* (vepra, 2022).

Sipas Ernest Koliqit, nëpërmjet kanunit *“populli shqiptar, jo vetëm që mori guximin dhe frymëzimin për një rezistencë më të fuqishme kundër barbarisë osmane, por i tregoi asaj perandorie dhe botës së asaj kohe se shqiptarët janë një popull që kanë zakonet e tyre, kulturën e tyre të shkuara dhe të respektuara me shekuj, ashtu që do ta dallonte përjetësisht me pushtuesit dhe nuk do të”* (një popullë, 2022). *“guxonte kush që ta cilësonte si një vend e popull pa ligje, pa zakone, pa diçka të veten, pra si një vend pa zot”* (pdf, 2022).

“Besa, burrnia dhe nderi kishin një rëndësi të veçantë për të drejtën zakonore shqiptare, mund të themi se ishin gurthemel i sjelljes personale dhe shoqërore” (Kanuni, 2022).

Kanuni e këshillonte popullatën se si duhej të vepronte në të gjitha aspektet e shoqërisë paramoderne shqiptare në vendet ku vepronte, në territoret ku sot shtrihet Shqipëria Veriore, Kosova, pjesa perëndimore e Maqedonisë e banuar me shqiptarë, Mali i Zi dhe Lugina e Preshevës.

Libri i dytë - FAMILJA

“Me familje nënkuptojm që çdo pjesëtar i familjes është i rëndësishëm për tjetrin dhe i domosdoshëm në të mirë e në raste fatkeqësish” (Kanuni I L. D., 2021). *“Familja është një grup njerëzish që jetojnë nën të njëjtën çati”* (Kanuni I L. D., 2021). *“Respekti dhe nderi*

ishin dhe duhet të jenë pjesët kryesore për ndërtimin e një familjeje të shëndoshë” (Kanuni I L. D., 2021). “Në atë kohë familja përbëhej prej shumë anëtarëve nga rrethi i gjere,numri i të cilëve shkonte deri në 70” (Kanuni I L. D., 2021).

Familja dihet që është pjesë e jetës që e jetojmë, pa familje jeta s’do të kishte kuptim. Pra, familja është pjesë e kanunit. Në atë shihet se sa vlerë të rëndësishme ka familja.

Libri i tetë – NDERA

“Ndera ishte dhe është gjëja kryesore për një familje.Secila familje në atë kohë i kishte rregullat që duheshin të përmbaheshin medeomos, njëra prej tyre ishte respekti dhe ndera, të cilat duhej të ishin prezente tek çdo anëtar i familjes” (Kanuni I L. D., 2021). “Këto dy karakteristika të familjeve shqiptare kontribuonin gjithnjë në një zhvillim të shëndoshë për mbarë familjen, fisin e katundin” (Kanuni I L. D., 2021).

Si popull njihemi të kemi rrespekt për njerëzit si psh. Ata të cilët janë më të vjetër duhet rrespektuar nga më të rinjtë, fjala e kryefamiljarit duhej të dëgjohej etj. Të nderosh dhe të rrespektosh njerëzit, atëherë është një kënaqësi dhe nder i madh.

Libri i njëmbëdhjetë - KANUNI I PLEQNIS

“Burrat e vjetër kanë pasur gjithnjë për detyrë mbajtjen e rregullave në një familje, mbajtjen e parave, bashkëpunimin me familje tjera për pronë ,mall etj” (Kanuni I L. D., 2021). “Kur pleqtë thonin se një gjë duhej bërë ,atëherë anëtarët tjerë të familjes vetëm duhet t’ia bënëin "Aminin" (Kanuni I L. D., 2021).

Prej më të vjetërve ndikim të madh ka pasur kanuni për mbarë familjen.

Dhe në trevën e Kosovës kanë qenë të njohur pajtimtarët dhe më të njohur janë ata të Drenicës. Për pleqni kryesisht thirren pleqtë që janë në zë për urtinë e tyre dhe që janë të stërvitur ndër pleqni të shumta.

Pleqtë apo pajtimtarët e gjaqeve kanë të drejtë që të shmangin çdo kërcënim që vjen për vrasje apo edhe dëm tjetër me urtinë e tyre që tregojnë, por edhe me fuqinë që kanë ata ndër fshatrat apo krahinat e tyre.

Një shembull të tillë të pleqnisë na e jep edhe shkrimtari Ramiz Kelmendi në romanin e tij “Heshtja e armëve”, ku babai i personazhes kryesore, Zojës, Rekë Zhuji me rastin se bija e tij Zoja kishte ikur në shtëpinë e Sokolit të Bardh Shukut.

Rekë Zhusë i kishte dalë problem tani me Kapllan Çelën e Pasbjeshkës, pasi që ia kishte dhënë vajzën që në djep për djalë.

Kapllan Çela i kërkon Rekë Zhujit që t'i thirrë pajtimarët e Rugovës dhe ata të vendosin për fatin e këtyre dy shtëpive.

Reka mbledh pajtimtarët dhe në fund ata vendosin që as Rekë Zhuji e as Bardh Shuku nuk janë fajtorë për atë që u ka ndodhur me fëmijët e tyre, duke i arsyetuar se tani ka ndryshuar kohërat, të rinjët pëlqehen vetë e jo me shkuesi.

Pra, në këtë mënyrë pajtimtarët i kanë penguar ngatërresat që të mos vijnë deri te gjakmarrja mes familjeve të ndryshme.

“Pra prej pleqëve tanë për nga rëndësia dhe ndikimi i madh që kanë pasur në kohën e kanunit është varur edhe respekti i mbarë familjes” (Kanuni I L. D., 2021).

“Emri Kanun, e ka prejardhjen nga gjuha greke: «kanón –κανών” e do të thote “vizore”, “riga” dhe tregon se kanuni është instrumenti, që shënon drejtesinë, pra është emertim metaforik, që spjegon “drejtesinë që mban kodi zakonor shqiptar”, “drejtesinë e Kanunit të Lek Dukagjinit”, “drejtesinë e Kanuneve të Maleve Shqiptare”, që ka udhëhequr, organizuar dhe drejtuar jetën e popullit shqiptar” (Kodi, 2022).

“Faik Konica shkruan:- Kanuni përfaqëson atë që ka mbetur nga mendimi juridik i Shqipërisë së Mesjetës, por mendoj se i ka rrënjët më përpara se Mesjeta” (Lutfi A., 2022)

“Në Kanun theksohet: gjithçka është kanun i trashëguem prej të parëve, çka evokon origjinën e lashtë të tijë, me zanafillë në vite të herëshme, në ato kohë antike, kur formohej etnosi ilir e në vazhdim kombi shqiptarë, kur ligjet, rregullat dhe normat etiko-morale të asaj kohe, konsolidonin funksionimin e mbretërive ilire dhe arbërore” (Kanuni I L. D., 2021).

Dihet se kanuni është i trashëguar prej të parëve, dhe nga ajo kohë ky kanun ka vazhduar të përdoret deri më sot, por tani më pak vazhdohen këto tradita kanunore. Jo se është lënë anash kanuni, por njerëzit kanë filluar që të ndërrojnë disa zakone.

“Në veçanti, Kanuni jo vetëm mbijetoi në shekujt e errët të pushtimit e të represionit turk, por ishte dhe aktiv, i ushtruar si e drejtëparalele me ligjet e Perandorisë Turke” (Kanuni I L. D., 2021).

Edhe pse ka qenë Perandoria Osmane, kanuni ka vazhduar të jetojë te populli shqiptar deri në fitoren e pavarësis së shtetit shqiptar.

“Në vitin 1880, një grup misionarësh franceskanë venecian, që jetonin e vepronin në Malësinë e Veriut, e gjejnë Kanunin të pranishëm dhe aktiv në popullatën malësore, çka e kanë dokumentuar në relacionet e shumta të dërguar qendres në Venecia (*La legge delle montagne albanesi nelle relazioni della Missione Volante – 1880*)” (Kanuni I L. D., 2021).

“Ekzistenca e një Kanuni në periudhën e ilirëve, nuk është e lehtë të provohet, por dhe nuk mund të injorohen shumë fakte, disa prej të cilëve përmbajnë të dhëna që duhen interpretuar me kujdes” (Kanuni I L. D., 2021).

“Në Arkivin e Shtetit Shqiptar ndodhen mbi 100 Kodikë, të shkruar që nga shekulli VI (pas Krishtit) e deri në fund të shekullit XIX, të cilët janë klasifikuar me kritere shkencore nga studiuesi i apasionuar Theofan Popa” (Kanuni I L. D., 2021).

“Ky thesar i çmuar i historisë e i kulturës shqiptare, është prezantuar dhe në një monografi dinjitoze nga studiuesi Shaban Sinani, i cili bën një analizë historike e përgjithësuese të përmbajtjes së kodikëve” (Kanuni I L. D., 2021).

“Për origjinën e Kanunit, shumë studiues insistojnë për origjinën e lashtë, madje dhe para mesjetës” (Kanuni I L. D., 2021). “Kanuni është përmbledhje ligjesh, të strukturuar në disa “shtresa”, nga antikiteti deri në ditët e sotme” (Kanuni I L. D., 2021).

“M.Vickers, në librin “*The Albanians*”, Londer 1995, shkruan: “Duke kërkuar rrënjët historike të Drejtës Iliro-Albanese, studiuesit e të drejtës komparative, thonë se Kanuni i Maleve është më i vjetër se sa “Ligjet e XII tabelave”, me zanafillë që në antikitet, madje e krahasojnë me “Ligjet Manu” (Manava-Dhama-Sastra), duke supozuar se kanë të njëjtën origjinë” (Kanuni I L. D., 2021).

“L.Fox “*Code of Lek Dukagjini*” (New York 1989), dhe Vangjel Meksi, sugjerojnë se kjo e Drejtë, sigurisht ka ekzistuar në Iliri, që në kohët preromane dhe është ruajtur e transmetuar brez pas brezi” (Kanuni I L. D., 2021).

“Faik Konica shkruan: “Kanuni përfaqëson atë që ka mbetur nga mendimi juridik i Shqipërisë të mesjetës, por mendoj se i ka rrenjët më përpara se mesjeta” (Kanuni I L. D., 2021).

“At Xhiusepe Valentini, pas një studimi të vëmendshëm dhe krahasues me kodet e tjera shkruan me kompetenca: “Kanuni i Maleve ka shumë elemente që lidhin me të drejtën romake” (kodi, 2022).

“Pandi Frashëri e përqafton këtë ide, madje në shumëaspekte avancoon në përcaktimin e lashtësis së Kanunit, duke e argumentuar me faktet se... në Kanun gjejmë institucione, ligje, doke e zakone dhe parime themelore, që të mahnisin me ngjashmerine perfekte me ligjet e Greqise dhe të Romës së lashtë” (Kanuni I L. D., 2021).

“Robert Elsie, në argumentimin për origjinën e lashtë të Kanunit preçizon: “Ligjet e të drejtës zakonore në Kanun, me kalimin e kohës janë ndryshuar dhe influencuar edhe nga të huajt” (Kanuni I L. D., 2021). *“Fillimisht janë influencuar nga ligjet romake, më pas nga ligjet e normat gjermanike, që i sollën në këto troje Gotet”* (Kanuni I L. D., 2021). *“Nuk mund të përjashtohet dhe influencë e kishës, sidomos e priftërinjëve dhe e murgjëve të zonave malore të Shqipërisë”* (Kanuni I L. D., 2021).

“Me intuitë dhe me llogjikë shkencore, Robert Elsie, mendon për zanafillen e këtyre ligjeve, që në periudhën e ilirëve, të cilët sigurisht kishin ligjet e tyre, si gjithë popujt e tjerë dhe me pas kanë marrë elemente nga e drejta romake, nga ligjet e gotëve, nga ligjet e bizantit, te normanëve e të tjera me rradhë, duke përfshirë dhe kishën me ndikimet e saj” (Kanuni I L. D., 2021).

Unë bashkohem plotësisht me këto opinione.

“Japonezi Kazuhiko Yamamoto me kompetenca shkencore dhe historike shkruan: “Kanuni ngjanë me veprat filozofike të Platonit dhe të Aristotelit dhe për më tepër, në Kanun gjejmë koncepte etike të shoqërisë greke, të asaj periudhe kur mungonte autoriteti i shtetit, çka të bind të mendojmë se Kanuni ka origjinë të lashtë” (Kanuni I L. D., 2021).

“Sipas studiuesit Behar Gjoka “katër esetë e realizuara, nga Yamamoto, më tepër anojnë nga e vërteta, nga interpretimi i thelluar i dukurive që trajton, ku mbizoteron argumenti i analizuar me thellesi” (Kanuni I L. D., 2021).

“Andersen: shkruan Kanuni është e drejta zakonore, që ka mbijetuar mbi 600 vjet, ka vepruar si një sistem për administrimin juridik të veriut të Shqipërisë, i cili historikisht ka jetuar i izoluar nga ligjet e qeverive qendrore” (Kanuni I L. D., 2021). *“Ky koncept, përkon me gjykimet e Nitzsche, mbi forcën refuzuese të popullit ndaj qeverive qendrore”* (Kanuni I L. D., 2021).

“Megjithatë, ritheksoj se të gjithë studiuesit e huaj dhe shqiptaret, historianë e specialistë kompetentë të të drejtës zakonore, insistojnë se Kanunii jonë e ka origjinën në lashtësi, që ka mbijetuar dhe ka vepruar ndër shekuj” (Kanuni I L. D., 2021).

“Për këtë të vërtetë askush nuk ka dyshime, por ende mbetet e pazgjidhur kur u bë kodifikimi i parë, kush ishin legjislatorët e parë, kush dhe çfarë modifikimesh i ka bërë Kanunit deri në vitin kur e mblodhi dhe e dokumentoj të shkruar At Shtjefën Gjeçovi” (Kanuni I L. D., 2021).

“Të gjithë duam te dime: a ka qenë i shkruar më parë Kanuni?” (Kanuni I L. D., 2021).
“Një pyetje tjetër është: Ku qëndron origjinaliteti i Kanunit të Maleve dhe a ka ngjashmeri me kodet e të drejtës të popujve të tjerë?” (Kanuni I L. D., 2021).

Kanuni si e drejtë zakonore, nuk ka qenë e shkruar në letër më parë, por është bartur gojarisht brez pas brezi nga popullata dhe sa i përket se kur filloi të hidhet në letër, mendohet aty në fillim të shekullit XX . Mendohet se kanuni ishte transmetuar nga popullata shqiptare gojarisht brez pas brezi për 500 vite rresht, derisa filloi ta mbledhë në letër At Shtjefan Gjeçovi.

“Fjala kanun s’ka dyshim se etimologjikisht rrjeth prej fjalës greke eaipi që don me thanë: mastar – një vegël e drurit a e ndonjë brumi tjetër, që tërheqë viza të drejta” (Merika, 2022). *“Quhet kështu Kanuni i Lekë Dukagjinit sepse thonë që ka qenë i pari ai i cili ka përmbledh e kodifikue rreth kanunit”* (Gjeçovi, f. 15).

“Këtë mendim e ka përkrahur edhe At Shtjefan Gjeçovi në librin e vet “Serbët dhe Shqiptarët”, (që është e përkthyer fq.90) thotë: “Gojdhana mbas së cilës këto zakone ligjore të quajtura me emrin “Kanuni i Lekës” është në lidhje me Lekën e III të Dukagjinit” (Gjeçovi, f. 15). *“Gjeçovi tregonte se në disa krahina apo republika të vogla që i quante ai aso kohe, thonte se kishin status të kodifikuar të vetin, por kanunin nuk e kanë lënë anash sepse ai ka qenë i përbashkët për të gjithë”* (Gjeçovi, f. 15).

Një ndër pyetjet që shpesh ia bënin për kanunin është: Në cilat vende të Shqipërisë-zbatohej më shumë kanuni? Për atë ka qenë mjaft e vështirë të përcaktohet sakt, por më shumë vlerë legale ka pas te malësorët e Shkodrës dhe në Dukagjin. Disa studiues thonë se për këtë arsye edhe është quajtur “Kanuni i Lekë Dukagjinit”, jo se ka qenë i kodifikuar prej Lekë Dukagjinit. Kanuni i Lekë Dukagjinit në pikëpamjen juridike, pas pushtimit të Perandorisë Osmanie në disa vende ka pasur vlerë, por më përpara ka qenë shumë më i kërkuar, ka pasur vlerë më shumë.

Në kanun ka disa ligje që kanë qenë e janë me rëndësi. Një ndër këto ligje është *“se gruaja kurrë nuk bie në gjak”* (Gjeçovi, f. 19).

Në kanun është përmendur edhe një fakt tjetër që disa i kanë quajtur shqiptarët si barbar, sepse kanë marrë gjak, por nuk është barbarësi marrja e gjakut, sepse ai është ligj kanunor, gjaku lahet me gjak.

Këto të dhëna për At Shtjefan Gjeçovin i ka shkruajtur Gjergj Fishta në dialektin gegë, jam munduar që t'ia përshtati në gjuhë letrare.

Përveç Gjergj Fishtës dhe Faik Konica që kanë shkruajtur për Gjeçovin, të cilin e kishin njohur prej së afërmi. Me atë ishte takuar në vitin 1913 në Shkodër, vetëm çka kishte dëgjuar për atë Faik Konica kishte respekt të madh, por kur e takoi dhe bisedoi edhe më shumë e rrespektonte. Faik Konica e përshkruante Gjeçovin si një njeri mesatar, i hollë, me sy të zinjë, ku i shkëlqente mendja dhe zemërmirësia. Kishte qenë njeri që s'ka folur shumë, por ato pak fjalë që i flite ishin fjalë të arta. Gjeçovi kishte qenë prift në një fshat, jetonte në Gomisque i pari katund i Mirditës në udhë nga Shkodra për në Orosh. Një ditë pyeti shokun e vet Faik Konica, pra Gjergj Fishtën se a do t'ia bëjnë një vizitë At Gjeçovit, ai pranoi dhe shkuan. Këta të dy ishin nga Shkodra. Duke shkuar për në Gosmique, ishte udhëtim shtatë a tetë orësh, gjatë asaj rruge nuk kishin pa askund, as një shtëpi të vetme, vetëm se një han të varfër. Kur mbërritën te fshati i Gjeçovit edhe aty ishte një fshat që ishin shtëpitë të shpërndara larg njëra-tjetrës.

Puna e At Gjeçovit, ai i mësonte fëmijët dhe i ndihmonte njerëzit, por edhe studionte.

“Gjergj Fishtës dhe Faik Konicës ia tregoi punën e vet që e kishte bërë në një punim ku aty ishin gati dymijë faqe studim, ku kishte mbledhur e radhitur të gjitha nga mendimet juridike të Shqipërisë në Kohën e mesme” (Shtjefën Gjeçovi, a.d.). Por me kanun nuk mund të ofrohet askush. Për Gjeçovin, Faik Konica thoshte se ai një ditë për Shqipërinë do të jetë gur i shëndritur.

KAPITULLI I DYTË

2.1 ANALIZË INTERTEKSTUALE E ROMANIT

Nocioni i intertekstualitetit është përdorur për herë të parë në vitet e '60 edhe pse mendohet se ai ishte zbuluar më herët. Për herë të parë e përdori këtë nocion Julia Kristeva. Ajo ka qenë e mendimit se çdo vepër letrare në vete ka ngërthyer elemente të intertekstualitetit. Mund të themi se çdo vepër letrare ka lidhje në një vepër tjetër.

Në çdo vepër letrare mund të gjejmë elemente të intertekstualitetit, por aty mund të bëhet edhe dallimi nga një vepër në tjetrën.

“Asnjë tekst nuk fillon nga hiçi, tekstet në vete bartin gjurmën dhe kujtesën e një trashëgimie dhe kujtesën e një teksti tjetër” (Shehabi, 2021). *“Çdo shkrim gjendet midis veprash të tjera që e paraprijnë atë dhe nuk është asnjëherë e mundur që ta fshijnë letërsinë”* (Shehabi, 2021).

Siç edhe thuhet çdo vepër letrare mund të ketë elemente të një veprë tjetër, shembulli siç është te vepra e Kadaresë që ka elemente të Kanunit, po dhe në shumë vepra të tjera mund të gjenden ngjajshmëri apo elemente të përbashkëta.

Studiues të cilët u morën me përkufizimin e nocionit të intertekstualitetit ishin :Julia Kristeva, Roland Barthes, Gerrard Genette, Michael Riffaterre, Mikhail Bartini, Harold Blum etj.

Sipas Julia Kristevës, *“Teksti është një kombinatore, vendi i një shkëmbimi të vazhdueshëm ndërmjet copëzash që shkrimi i shpërndan duke ndërtuar një tekst të ri nga tekste të mëparshme, tekste këto të shkatërruara, mohuara, rimarra”* (Isufaj, 2022).

“Për Bakhtinin çdo shprehje është e rrënjosur në një kontekst shoqëror i cili e shënon atë thellësisht, dhe është e kahëzuar drejt një horizonti shoqëror” (Piegay-Gros, 2011, f. 39).

“Sipas Barthes çdo tekst është një intertekst; të tjera tekste janë të pranishme në të, në nivele të ndryshme, në forma pak a shumë të njohshme: çdo tekst është një thurrje e recitimesh të kaluara” (Piegay-Gros, 2011, f. 21).

Nga këto përkufizime të këtyre autorëve vijmë në përfundim se çdo vepër letrare mund të ketë ngjashmëri të një teksti me një tekst tjetër. Kjo mund të quhet ndryshe komunikim i veprave në mes veti, sepse në çdo vepër mund të gjendet ky lloj i teksete të përbashkëta.

Sipas M.Bakhtin, J.Kristeva, Zh.Zhanet etj., *“Çdo tekst është në një farë mënyre intertekst”* (Piegay-Gros, 2011, f. 21).

Këtij përfundimi i vishet edhe një çështje tjetër që kërkon përgjigje dhe ilustrim; çështja e lexuesit që do të thotë teoria e intertekstualitetit tekstin e jep si material të shumëstresuar, por zbërthimin e tij e sheh si të varur nga perceptimi i lexuesit”.

“Michael Riffaterre e përkufizon intertekstualitetin: Intertekstualiteti është shquarja, nga ana e lexuesit, e raporteve ndërmjet një vepre të dhënë dhe veprave të tjera, që e kanë paraprirë intertekstin e së parës” (Rikthimi i mitit në v. e K., 2022).

“Intertekstualiteti është menduar si dukuri imitimi dhe si dukuri zinxhir ashtu siç thotë edhe Laurent Jenny intertekstualiteti flet një gjuhë fjalori së cilës është shuma e teksteve ekzistuese” (Piegay-Gros, 2011, f. 22).

Modeli i aluzionit në veprën e Kadaresë është pikërisht nga vepra e Shtjefan Gjeçovit *“Kanuni i Lekë Dugagjinit”* dhe lexuesi sinjalet negative është në gjendje t’i kthejë në pozitive.

“Aluzioni është krahasuar shpesh me citimin, por për arsye krejt të ndryshme: sepse ai nuk është as i mirëfilltë dhe as i hapur, por mund të ngjajë më i fshehtë dhe më i hollë” (Isufaj, 2022).

“Aluzioni letrar nënkupton në fakt që lexuesi do ta kuptojë me fjalë të zbuluara atë çka autori dëshiron t’ia thotë pa ia thënë haptas” (Piegay-Gros, 2011, f. 75).

Nga fjalitë e poshtë shënuara në tekst, që janë të marra në veprën e Kadaresë kuptohet që kemi të bëjmë me aluzion letrar.

“Shikoje këmishën, Gjorgu ktheu kryet andej. Iu duk se dejet e qafës i kërcitën sikur t’i kishin zënë ndryshk” (p. i thyer, 2022).

-Gjaku po zverdhjet në të,-tha i ati” (F. Tub, 2022) “- *I vdekuri kërkon shpagim*” (Kadare, Vepra-v.11-Prilli i thyer, 2009, f. 62). “- *Ti po vonon shumë, Gjorg,- vazhdoi i ati*” (f. nderi, 2022) “- *Nderi ynë, por sidomos yti...*” (Kadare, Vepra-v.11-Prilli i thyer, 2009, f. 62).

Në bisedën që zhvillohet mes prindit dhe të birit, të cilët flasin për këmishën e të vrrarit e cila varej në katin e sipërm të shtëpisë, dhe sipas fjalëve të babait të Gjorgut ajo dita-ditës sa vinte e zverdhej, dhe se kishte ardhur momenti që Gjorgu duhet ta marrë gjakun e vëllait.

Këtë nxerrje të gjakut mund ta bënte edhe babai i tij, por ai nuk e bëri këtë, por me fjalët që i thoshte Gjorgut e nxiti atë që ta bënte këtë vrasje. Gjorgu i ri në moshë dhe ende nuk e kishte shijuar jetën sipas rregullave të kanunit duhej të bëhej vrasës, pa dëshirën e tij. Pra, kjo ishte e keqja e prindërve se ata ishin nxitësit kryesorë të gjakmarrjeve dhe këtë e bënin nëpërmjet fëmijëve të tyre.

“Ceremonia e përmotshme u bë të nesërmen në mesditë” (suplementi, 2022). *“Gjëmatarët erdhën nga larg, duke grisur fytyrat e duke shkukur flokët sipas dokeve”* (suplementi, 2022).

Pra, aluzioni i gjamës së Lekë Dugagjinit në vdekjen e Skënderbeut është i dukshëm në veprën. Pra, ky aluzion bëhet në mënyrë të qëllimshme nga autori i veprës, me arsyetimin që lexuesi të njihet me gjamat, me këtë lloj të lirikës familjare, këngë të cilat këndohen me rastin e vdekjes së ndonjë personi.

Nga gjama shprehet dhimbja për njeriun që ndahet përgjithmonë nga rrethi familjar shoqëror.

Te shqiptarët thuhet se kjo traditë e vajtimit është e lidhur me vdekjen e Skënderbeut. Shënimin më të lashtë të gjamave e gjemë te vepra e Marin Barletit *“Historia e jetës dhe veprës së Skenderbeut”* (Skenderbeu, 2022), kur Lekë Dugagjini merr lajmin për vdekjen e kryetrimt dhe nga trishtimi se shqiptarët kanë humbur njërin nga luftëtarët më të mëdhenj që kishte, del në ballkonin e shtëpisë dhe fillon ta shkullë mjekrën, flokët, ta rrahë gjoksin dhe të bërtasë.

Sipas studiuesve esenca e këtij rituali ishte që të largohej dhimbja, por edhe respektohej i vdekuri. Mendohet se ky rit ishte i pranishëm në regjionet e Shqipërisë, si: Nikaj, Mertur, Dugagjin, Malësia e MbiShkodrës, Pukë dhe Kosovë. Ky rit mortor i bërë nga Lekë Dugagjini u kthye në zakon dhe vazhdoi deri në vitet e '60-ta, kur u ndalua nga sistemi

komunist duke e konsideruar si zakon prapanik.

Një ngjarje të tillë e kemi edhe te vepra e Homerit “Iliada”, kur Hektori në luftë e sipër vret Patroklin dhe Akili nga dhimbja e madhe për të, filloi të bërtiste, të rrihte gjoksin, të shkulte flokët dhe të gërvishte fytyrën. Gjamat si traditë e lashtë i gjejmë edhe 4000 vjetë më parë në veprën Gilgameshi. Mbreti i Urukut kur vajton shokun e tij Enkidujin për gjashtë ditë rresht, duke bërtitur me zë të lartë, duke shkukur flokët, duke shqyer rrobat dhe të shtatën ditë e varrosë.

Në këtë roman të Ismail Kadares, “Prilli i thyer” nga ajo që kam lexuar kam kuptuar se kemi të bëjmë me formën e intertekstualitetit, aluzionin. Në çdo formë autori kuptohet se çfarë dëshiron të tregojë, poashtu emri i autorit të veprës dihet, emrat e personazheve etj. Më këtë e kuptojmë formën e aluzionit. Kjo formë është më tepër e përdorur në këtë roman.

Një nga funksionet që ka qenë i rëndësishëm te intertekstualiteti ishte në veçanti romani me personazhet e veçuara. Ku aty duhet të ishin të spikatur personazhet e veprës. Si mund të bëhet rrëfimi i një vepre? Mund të bëhet me rrëfimet e personazheve, psikologjinë e atyre, diturin, vendin etj. Sikur që i kishte përshkruar autori te “Prilli i thyer”.

Ashtu si i kanë përshkruar personazhevet në roman, te romani në fjalë janë të veçorizuar *“personazhet, Gjorgu ka rolin e ti që duhet të marrë gjakun, Diana ishte simbol i gruas së fortë, Besiani një njeri i shkolluar etj., pra këta personazhe plotësojnë vetveten përmes daljes nga vetvetja që kanë njohur, nga vetja që u kanë mësuar, nga vetja që kanë pranuar në heshtje”* (Jeta p. v. nga vdekja, 2022).

2.1.1 Kulti i mikut në shtjellimin e romanit

Tragjedia që përcillte prej dy shekujsh familjet e Berishajve dhe Kryeqyqëve, pikërisht kishte nisur për mikun e prerë në besë. Duke hyrë thellë në psikikën e malësorit, Kadareja shkruan: *“ndërsa shumë popuj i kanë ruajtur malet për hyjnitë, malësorët tanë, duke qenë se i kanë ato të vetmet trajtë burimi, kanë qenë të detyruar, ose t’i dëbojnë hyjnitë prej andej, ose t’i përshtasin sipas vetes, në mënyrën që të jetojnë të përzier me ta”* (P. i Th., 2022). Kështu autori shpjegon krijimin e gjysmëhyjnive të tilla, siç është mikut, si në kohët Homerike.

“Për ta vërtetuar këtë thënie të moçme, Kadare e precizon këtë te romani Prilli i thyer, duke thënë: “Gjaku i të atiti e i të birit mund të falej, i mikut kurrë” (Kadare, Vepra-v.11-Prilli i thyer, 2009, f. 79).

Privilegji më i madh i mikut në kanun ishte ndorja apo mbrojtja. Miku posa hynte në shtëpin, ishte i mbrojtur dhe konsiderohej si zot. Edhe po të ishte në hasmëri me familjen ku kishte trokitur për konak dhe nga padija që ishte në gjak me ta, ai prapëseprapë respektohej dhe ishte i mbrojtur gjatë qëndrimit të tij aty.

“Mikpritja konsiderohet institut dhe zakon popullor” (L. e shqiponjave, 2022). Udhëtari që hynte në shtëpi, vihej vetvetiu në mbrojtjen e asaj shtëpie dhe ishte *“i zoti i shtëpisë që mbante përgjegjësi për mbrojtjen e mikut deri kur dilte jashtë shtëpisë ose tokës së tij”* (L. e shqiponjave, 2022).

Aq shumë rrespektohej miku, dhe po që se dikush e fyente atë, marrja e hakut ishte detyrë e zotit të shtëpisë.

Kështu duke rrespektuar mikun e familja e Berishajve ra në hasmëri me familjen e Kryeqyqëve, gjakëmarrje, e cila nuk u ndal prej shtatëdhjetë vitesh duke marrë dyzet e katër kufoma në të dyja palët. Gjorgu ishte në mëdyshje për ta vazhduar ose jo gjakëmarrjen, por ishte i shtyrë nga babai i tij që të marrë hak.

Këtë e bën kur ia zuri pritën Zef Kryeqyqes dhe e vrau me një plumb.

2.1.2 VRASJA

Vrasja është pjesa më e ndishme e traditës shqiptare, është plagë e rëndë, ku përshkak të saj dhe ndikimit nga kanuni, shumë familje shqiptare kanë mbetur të ngujuara. Gjorgu për t’u hakmarrë për vrasjen e vëllait, i cili ishte në mëdyshje për të nxjerrë hak, por këtë vrasje e bëri për hatër a po nder të babait të tij edhe se ishte i vetëdijshëm se automatikisht do ta humb edhe jetën e tij.

Duke qenë se Gjorgu ka vrarë, pret që edhe ai të vritet pas kalimit të besës së madhe dhe e vetmja ëndërr i mbetet që ta shtyjë sa më shumë çastin e vdekjes, duke bredhur fshehtas nëpër Rrafsh apo duke u ngujuar në kullat e ngujimit.

Këtë vrasje Gjorgu *“e bën sipas rregullave kanunore, me një plumb përballë dhe duke ia kthyer trupin mbarë”* (SHEHABI-VESELI & MALOTA, 2022) dhe duke ia afruar pushkën.

Këtu shihet se autori ka cituar kanunin dhe flet hapur për raportin intertekstual që ka vepra me kanunin. (Shtjefan Gjeçovi, Kanuni i Lek Dukagjinit, kreu e njëzet e dytë – vrasja)

“Gjorgu ashtu siç e donte zakoni, i foli njeriut që po vinte” (suplementi, 2022)

Pasi e qëllloi dhe i bindur se viktimja kishte vdekur “Gjorgu doli nga prita dhe eci drejt të vrarit. I vdekuri kishte rënë përmbys” (fragmenti, 2022). “Gjorgu u përkul mbi të dhe i vuri ... mbi njërin sup si për ta zgjuar” (fragmenti, 2022). “Kështu pra, donte vetëm ta kthente trupin mbarë, ashtu siç e kërkonte zakoni” (fragmenti, 2022).

Interteksti i besës mes romanit “Prilli i thyer” dhe “Kanunit të Lekë Dukagjinit”

2.1.3 BESA

“Mund të thuhet se një nga vrytytet më të lashta të popullit shqiptar është edhe besa” (Arena dardane, 2022). “Duke u bazuar në traditën shqiptare që nga momenti kur dikujt i jepet besa, personi apo fisi i cili ishte pjesë përbërëse e kësaj lidhjeje, për ta mbajtur atë duhet sakrifikuar edhe jetën” (Arena dardane, 2022).

Shumë studiues mendojnë që besa, ishte simbol i shqiptarëve, që nga kohërat e lashta, të cilin e kanë trashëguar deri në ditët e sotme.

Besa shqiptare mendohet se ishte një lloj i kushtetutës apo ligj i saj, aty ku mungonte shteti vepronte besa. Kjo shihet edhe te “Kanuni i Lek Dukagjinit,” që “u përdor për eliminimin e hakmarrjeve, ku persona të zgjedhur të fiseve kërkuan besën për çaste të caktuara.” (Besa, 2022). Përmes besës tregohen vlerat morale të popullit shqiptar ndër shekuj.

“Konceptin e besës, romansieri Ismail Kadare na e sjell si intertekst të kanunit në romanin “Prilli i thyer” (Gjeçovi, f. 82).

Në romanin “Prilli i thyer”, pas vrasjes së Zef Kryeqyqës nga Gjorg Berisha.

“Ndërmjetësit po shkojnë të kërkojnë besën njëzetekatërorëshe për Berishajt, -thoshte dikush nga një dritare” (suplementi, 2022).

Derisa familja Berishajve dhe farefisët e tyre, po merrnin masat mbrojtëse që mos të vritet dikush nga familja tjetër të cilët ishin të verbuar nga gjaku i derdhur i Zefit dhe meqë edhe me kanun ishin të lejuar të shtinë mbi këdo nga familja e Berishajve, përveç grave dhe fëmijëve.

“ Më në fund katër ndërmjetësit dolën. Biseda kishte qenë e shkurtër” (f. ecje, 2022). “Nga ecja e tyre nuk kuptohej asgjë, gjersa një britmë e shpërndau lajmin” (suplementi, 2022). “Familja e Kryeqyqëve e çeli besën” (Kadare, Vepra-v.11-Prilli i thyer, 2009, fv. 30-31).

Në traditën shqiptare të pjesës veriore të Shqipërisë e sidomos me ligjet e Kanunit të Lekë Dukagjinit, jepeshin dy lloje besash: besa njëzet e katër orëshe dhe ajo tridhjetë ditëshe, në nenin 858 dhe 859 të njëjës së njëqind e njëzet e dy. Për të marrë besën tridhjetëditëshe shpija e dorasit, me kanun, ishte e rregulluar se nëse dorasi nuk shkon në ceremoninë e varrimit të të ndjerit dhe në drekën e mortit, po nuk i dhanë besë familja e Kryeqyqëve nuk i zihet për zhburrnim shpisë së të vramit, ngase konsiderohej si shtim i dhunës mbi dhunë.

Duke i respektuar këto tradita shqiptare, edhe përkundër kundërshtimit të Gjorgut për të marrë pjesë në varrim dhe drekën e mortit, por me insistimin e babait dhe duke e respektuar kufomën e të vvarit, familja e Berishajve fitoi besën tridhjetëditëshe.

Besa tridhjetëditëshe jepej pas besës njëzetekatërorëshe.

Por, kjo dhënie e besës thuhet ishte e kushtëzuar nga dorasi. Sipas Kanunit, nëse dorasi nuk shkonte në ceremoninë e mortit dhe drekën për të ngrënë te shtëpia e të vvarit, ishte e vështirë të jepej besa e madhe (tridhjetëditëshe).

Sipas traditave zakonore, me shkuarjen e dorasit në ceremoninë mortore, ishte një akt shumë pozitiv, ngase me këtë respektohej kufoma e të vvarit.

Besa e madhe merrej nga pleqtë e fshatit që ishin një këshill për pajtimin e gjaqeve.

Me dhënien e besës tridhjetëditëshe, nënkuptohej se dorasi ka kohë të bollshme për të paguar tagrin e gjakut, por edhe fisi i dorasit për t'i kryer punët e bujqësisë që kishin.

Brenda kësaj periudhe tridhjetëditëshe janë të lirë i gjithë fisi dhe brenda kësaj kohe janë të lirë t'i kryejnë punët që kanë rreth shtëpisë dhe pas skadimit të besës, shtëpia e dorasit duhet të mbyllet mbrenda dyerve. Të vetmit që ishin të lirë dhe kur nuk jepej besa ishin gratë dhe fëmijët.

Një nga virtytet më të hershme të ilirëve dhe pasardhësve të tyre, shqiptarëve është besa. Një nga faktorët që ka ndikuar në mbijetesën e popullit shqiptar ndër shekuj është besa. Përveç besëlidhjeve të ndryshme që patën shqiptarët, kur populli i kanosej rreziku, ajo shërbeu dhe në eliminimin e hasmërive mes fiseve të ndryshme, por me të tregohen edhe vlerat morale dhe të karakterit, të popullit shqiptar.

Besa, si virtyt i lartë moral, mendohet se lindi si nevojë e solidaritetit mes bashkësive fisnore, kjo konsiderohej si një akt hyjnor dhe sipas kësaj, pesha e fjalës së dhënë ishte më e

rëndë se çdo gjë.

Këtë akt të respektimit të kufomës sipas kanunit nga Gjorgu, Ismail Kadareja na e sjell edhe te romani në formën e intertekstualitetit.

Këtu kemi formën e intertekstit të aluzionit. Këtu është formuar teskt mbi një tekst tjetër dhe kjo formë në intertekstualiteti njihet si aluzion.

“ *Besa e madhe u dha prej Kryeqyqëve pasdite vonë, pak kohë përpara se të mbaronte afati i së voglës*” (suplementi, 2022). “*Një nga pleqtë e katundit që kishte qenë te Kryeqyqet, erdhi në kullën e Berishajve dhe njoftoi për dhënien e saj, duke përsëritur, më këtë rast këshillat e nevojshme se si Gjorgu nuk duhej ta shpërdoronte atë*” (suplementi, 2022).

2.1.4 KËMISHA E PËRGJAKUR

Në traditën shqiptare ishte zakon që këmisha e përgjakur e personit të vrarë të varet në ballkonin e katit të sipërm të kullës dhe aty të qëndrojë derisa të merrej gjaku.

Dhe derisa kjo hiqej kur merrej gjaku, vihej në katin e shtëpisë tjetër, ku ishte i vrari. Kështu kishte ndodhur edhe me familjet e Berishajve dhe Kryeqyqëve, të cilët për këto shtatëdhjetë vite hasmëri kishin të varura dyzet e katër këmisha.

Këmisha e të vrarit nuk hiqej nga andej, ashtu e lyer me gjakun e viktimës ajo dita-ditës zverdhej dhe kjo kishte kuptimin se i vdekuri nuk gjenë qetësi derisa të merrej haku.

Disaherë brenda kësaj periudhe sa kishte qëndruar këmisha e varur e vëllait, Gjorgu e kishte parë në ëndërr dhe kur ngrihej në mëngjes ajo ishte prap aty, plot njolla gjaku të tharë.

Shkaku për ta kryer këtë vrasje apo për të marrë hak për vëllain ishte këmisha e varur e zverdhur, por edhe i ati i Gjorgut, i cili gjithnjë përpiquej të rindizte urrejtjen ndaj Kryeqyqëve.

Këtë më së miri autori na e sjell në veprën “Prilli i thyer”,-

“*Shikoje këmishën- tha tjetri duke bërë me kokë nga këmisha e varur në murin përballë*” (F. ndryshk, 2022).

“*Gjorgu ktheu kryet andej. Iu duk se dejet e qafës i kërcitnin sikur t'i kishin zënë ndryshk*” (Kadare, Vepra-v.11-Prilli i thyer, 2009, f. 62).

“Gjaku po zverdheth në të,- tha i ati. I vdekuri kërkon shpagim” (Kadare, Vepra-v.11-Prilli i thyer, 2009, f. 62).

“Ti po vonon shumë Gjorg,-vazhdoi i ati” (Kadare, Vepra-v.11-Prilli i thyer, 2009, f. 62).

“- Nderi ynë, por sidomos i yti” (Kadare, Vepra-v.11-Prilli i thyer, 2009, f. 62).

“Në këtë pjesë ku na paraqitet aluzioni si intertekst, është ngjajshmëria e “këmishës së përgjakur” me pjesën e veprës së Shekspirit “Hamleti”, kur Hamletit derisa ishte jashtë vendit i paraqitet fantazma e babait” (Bibla, 2022).

“Sipas traditës këmisha e të vrarit të familjes, rri e varur në çati derisa njëri nga anëtarët e familjes ta marrë gjakun” (Bibla, 2022). *“Nëse marrja e gjakut vonon me vite, këmisha fillon ta humbas ngjyrën dhe është tregues marrja e gjakut po vonohet dhe se shpirti i të vrarit nuk prehet në paqë”* (Bibla, 2022).

“Sa i përket krahasimit mes fantazmës së babait të Hamletit dhe këmishës së përgjakur që rri varur nuk ka koment, ngase ajo fantazmë iu shfaq Hamletit vetëm tre ditë, ndërsa këmisha e përgjakur të rrinë pranë syve, ndoshta me vite të tëra” (Bibla, 2022). *“Shekspiri duke e shfaqur fantazmën e mbretit si”* (Bibla, 2022), krijim absurd dhe abstrakt dhe me këtë krijojnë një ide origjinale të ftuarjes në hakmarrje, ndërsa Kadareja i referohet traditës së njëmendte të popullit shqiptar.

KAPITULLI I TRETË

3.1 JETA PËRMES VËSHTRIMIT NGA VDEKJA

Ta jetosh jetën sikur të jetë dita e fundit e jetës është vështirë. Në këtë roman autori e përshkruan vdekjen në çdo hap që ec njeriu. Çdo pjesë e jetës që e jeton njeriu ka rëndësinë e vet. Për një djalosh që ishte në lule të rinisë ishte shumë e vështirë që ta përceptonte jetën e tij me vdekje, sepse vdekja për të ishte çdo kund, në çdo hap.

“Njësoj si Erosi, vdekja është një nga temat e privileguara të letërsisë që e përshkruan, e fut në një sistem të ndërliqshëm dhe e vesh me vlera simbolike dhe etike” (Jeta, 2022). “Ajo është mbathur prej njeriut me aq shumë domethënie (ndoshta edhe më shumë se Erosi), sa do të ishte e pamundur t’i radhisnim të gjitha, e që vijnë prej kulturës e njohjes së përbashkët” (JETA P. V. NGA VDEKJA, 2022).

Jeta e këtijë djaloshi të rri mori një kthesë ndryshe në momentin që e mori gjakun për të vëllanë, megjithëse atë vrasje e kishte shtyer shumë që mos të jetë i privuar nga jeta, por kanuni apo zakoni e donte ashtu. Për Gjorgun ishte absurde që të marrë një jetë njeriu. Tani jeta e tij mori kahje tjetër në momentin e vrasjes, për të çdo gjë ishte e lidhur me jetën, vdekjen dhe besën. Tani jeta e tij ishte jetë e jetuar për të tjerët, sepse jeta e tij kishte mbaruar.

Në këtë roman “Prilli i thyer” autori e përshkruan vdekjen si gjë e natyrshme, çdo gjë ishte e ditur për ngjarjet që do ndodhin këtu, si: vdekja, gjakëmarrja, besa, pra vet lindja e një djali tregon hakëmarrjen që duhet marrë.

Jeta ka një vlerë të madhe për çdo qenie të gjallë. Vetë fjala jetë të bën të jetosh një jetë sado pak të lirë e të lumtur. Në këtë roman fjala jetë ka shumë vlerë, rëndësia e jetës është e

madhe. Ta analizosh dhe ta vështrosh jetën përmes vështrimit nga vdekja është shumë e rëndë, një vdekje për së gjalli ndoshta mund ta quajmë këtë. Jeta është aq e shkurtër vetëm kur ta mendosh, por në momentin që ti e vështron përmes vdekjes atëherë është dhe më e vështirë. Në momentin që e ke të caktuar vdekjen apo ditët e numëruara atëherë ajo është një jetë krejt ndryshe, ndryshon e gjithë konceptin i jetës. Për çdo njeri synimi i jetës është e ardhmja por në këtë roman synimi i jetës është se si ta jetojë dhe një ditë, e ardhmja ka humbur apo është harruar për atë njeri.

“- *Është vdekja!*».” (JETA P. V. NGA VDEKJA, 2022). “*Për Mateo Mandalanë, profesor i gjuhës dhe i letërsisë shqipe në Universitetin e Palermos, mungesa, vdekja dhe flijimi, tri tema, që përsëriten në mitologjinë e të gjitha kohëve dhe të të gjithë popujve, përbëjnë tri majat e atij trekëndëshi hyjnor që kufizojnë lëmin e letërsisë*” (Baçi, 2022).

Mund të themi që shumë vepra letrare kanë këto tri tema të trajtuara në romane, poezi, prozë etj. për vdekjen mund të themi që është më e përhapura. Si edhe e përdor profesori në fjalë, që çfarë do kohe të ishte vdekja është aty.

“*Një bashkëjetesë të përqendruar të dashurisë, mes vdekjes dhe ëndrrës, padyshim që mund ta gjejmë më të theksuar te „Prilli i thyer”* (JETA P. V. NGA VDEKJA, 2022). “*Për t'u futur më pas vrullshëm brenda shpirtit të tyre, atje ku s'kanë guxuar të shohin, por që janë, që mund të jetojnë ashtu*” (Baçi, 2022).

Gjorgu një djalë i ri, që u detyrua ta jetojë jetën duke e parë vdekjen si hije të tij. Pse? Detyra e tij ishte që ta kryente obligimin e moralshëm sipas traditës shqiptare, pra ta merrte gjakun për të vëllanë. Të gjithë mendonin se ai nuk do ta merrte gjakun, por për Gjorgun dhe jetën e tij nuk i interesonte askujt. Në plotësimin e kushtit apo obligimit që e kishte jeta e Gjorgut tani ishte krejt ndryshe, ai nuk mendonte si të rinjtë e tjerë për të ardhmen, por ai mendonte si ta siguronte edhe një ditë jetë. Çdo hap që ecte për të nuk ishte i sigurt, ecte me frikën se do të vritet çdo sekondë.

Në letërsi është normale të flitet për jetën dhe vdekjen, se prej se ka ekzistuar letërsia këto kanë qenë temat kryesore të romaneve.

Te ky roman i Kadaresë gjejmë dashurinë, vdekjen dhe ëndërrimet. Për dashurinë autori flet me një mënyrë ndryshe, sepse aty ai shpreh ndenjat e dy të dashëruarve që as nuk ia kishin idenë se ku po gjindeshin dhe në çfarë gjendje mund të ishin. Dashuria është një ndenjë që ndoshta nuk mund t'i thuash të gjitha, por ajo ka gjuhën e vet e cila flet vet.

Diana dhe Gjorgu dy të dashuruar, që nuk e menduan vdekjen, dy të dashuruar që vetëm me një takim të rastësishëm që patën, lindi shkëndija mes tyre.

Vdekjen e gjejmë kudo në këtë roman, sapo të përmendet Gjorgu menjëherë mendja të shkon te vdekja.

Ëndërrimet e këtij djaloshi dhe shumë të rinjëve të moshës së tij marrin fund në momentin që janë në hasmëri. Ëndërrat për të ardhmen në Rrafsh mund të ndërprehen në çdo moment, aty nuk i dihet se kur del diçka që e do zakoni apo tradita dhe çdo gjë përfundon. Çdo gjë që është e lidhur me jetën mund të përfundon nëse zakoni e kërkon. Ëndërra e secili të riu është që ta ketë një pjesë të jetës të cilën e jeton të mirë dhe një të ardhme e të ndritur.

3.1.1 MENDIMI I GJORGUT PËR TË MOS MARRË GJAKUN

Sipas autorit Ismail Kadare, poashtu edhe Kanunit të Lekë Dukagjinit mosmarrja e gjakut, vetëm ta mendosh nuk ishte e hijshme dhe e logjikshme, e sidomos në pjesën e Shqipërisë së Veriut dhe në vitet se kur është e shkruar vepra e autorit.

Me këtë gjest Gjorgu bie ndesh me kanunin, familjen dhe fisin. Për këtë djalë të ri që ishte më së miri ta vazhdonet jetën, ai duhet të mendojë shëndetshëm se si ta marrë gjakun për të vëllain Mëhillin. Ai asnjëherë nuk e kishte përmendur që nuk donte të merrte gjakun për të vëllain. Ai vetëm e shtynte marrjen e gjakut, por çdo ditë që u zgjonte ia përkujtonte babai i tij, që ka një punë pambaruar. Për Gjorgun ai vit ishte shumë i vështirë. Sa donte që ta harronte se duhet marrë gjaku nuk mundte, sepse këmisha e vëllait ishte e varur në ballkon të shtëpisë dhe ta shohësh për çdo ditë. Në vendin që jetonte Gjorgu, pra dihet se çdo gjë duhet të zbatohet me kanun dhe kanuni e kërkonte që të merret gjaku. Këmishën e të vëllait të tij, që e shihte çdo ditë, i dukej sikur mungonte respekti për të vëllain që e kishte vonuar marrjen e gjakut, ishte edhe ana tjetër se ai s'donte që të vazhdonte kjo gjakmarrje, edhe pse Gjorgu nuk pyetej për këtë.

3.1.2 FUSHAT E PUNUARA DHE TË PAPUNUARA

Fushata e punuara dhe të papunuara, kjo shenjë ishte shumë e kuptueshme, sidomos për ata që merren me kanun. Kjo gjendje e këtyre njerëzve se si vepronin në tokat e tyre ishte deri sa kishin për ta kryer vrasjen.

Këto ara të lëna disa, e disa të punuara, ishin pasqyra më e mirë e mundshme të shihet se si iu kalonte jeta atyre njerëzve në Rrafsh që ishin në gjak dhe atyre që nuk ishin.

3.1.3 TAKIMI RASTËSOR-DASHURIA

Takimi i Dianës me Gjorgun ndryshoi jetën e këtyre dy të rinjëve, duke hequr dorë nga një jetë pa kuptim dhe duke mbushur jetën e tyre me një ndjesi të veçantë. Ajo shigjetë rrufeje që goditi zemrat e tyre në shikimin e parë, ishte një sinjal që ngjalli tek ata dashurinë sa do të vogël të ishte ajo në një vend ku jeta ishte mëse e vështirë.

Përballja e tyre e parë në mes Dianës dhe Gjorgut është se ata nisen nga dy botë krejt të kundërta, por drejt së njëjtës kullë, atë të Oroshit, ku pronari i kullës ishte gjithçka për rrafshin, ishte shtet më vete, ishte kryetar, ishte gjykatës etj.

Diana ishte nisur për në muajin e mjaltit me të shoqin e saj, ndërsa Gjorg Berisha ishte në muajin e besës së madhe apo më mirë të themi në “muajin e vdekjes”.

Në këtë rrugëtim të mundimshëm drejt kullës së Gjakmarrjes, ku Gjorgu duhej të paguante tagrin e gjakut, ndodh një ndryshim e që ndizet në momentin kur Diana dhe Gjorgu shihen përherë të parë, ajo brenda karrocës e ky në kryqëzimin e udhëve.

Gjorgu, duke qenë një fshatar i thjeshtë si shumica e të tjerëve të ngjuar brenda mureve të shtëpisë, nuk kishte as njohurinë më të vogël rreth dashurisë, përveçse që ishte i fejuar edhe atë me shkuesi, por për fat të keq ajo vdiq.

Dhe nga momenti kur Gjorgu pa Dianën, ai ndjeu një lëvizje tjetër brenda vetes dhe tek ajo pa një zanë malesh, e cila mund t'ia ndryshojë edhe jetën.

Që nga ky çast, Gjorgu as edhe njëherë nuk pushoi së kërkuar Dianën nëpër rrugët e ndryshme të Rrafshit, në bujtina dhe në kullat e ngujimit.

Ai ballafaqim me Dianën i la një vrugë të madhe në zemrën e tij. Nga dëshira për ta parë edhe njëherë, ai gati tërë kohën e besës tridhjetëditëshe e kaloi nëpër Rrafsh, edhe pse mund të vritej. Nuk mërzitej fare për të, ngase vdekjen e kishte të paracaktuar, por këto ditë deshi ta shijoj jetën.

Kur Diana e pa përherë të parë Gjorgun, edhe te kjo pati një ndryshim të ndjenjave, edhe pse burrin e kishte pranë. Pasi u larguan nga Gjorgu, ajo kudo që të shkonte mendimin e kishte tek ai. Te Gjorgu ajo pa një djalë të ri e muskuloz, me tiparet e një malsori të Rrafshit, por që të kujton kreshnikët e maleve shqiptare.

Edhe pse gratë e kishin të ndaluar të hyjnë në kullën e ngujimit, ajo pa u hamendur fare dhe nga dashuria për “ princin e saj”, hyri në kullën ngujimit duke besuar se aty ishte Gjorgu dhe kjo ishte një ngujim për jetën.

Mund të themi se “*Diana niset për në Kullën e Vdekjes, por nga andej kthehet si një udhëtare në Kullën e Jetës*” (Jeta p. v. nga vdekja, 2022). “*Ajo niset me burrin e saj drejt kullës se Gjekmarkajve për të parë jetën e vështirë të banorëve të Rrafshit që jetojnë me vdekjen për çdo çast, ndërsa kthehet me drithërimën e ambël të jetës*” (Jeta p. v. nga vdekja, 2022).

Edhe gjaku borxh i Gjorgut për Kryeqyqët zhvendoset me gjak borxh për dashurinë. Tani edhe mund të mos e dijë kush do të qëllojë mbi të, por edhe as nuk ka kurfarë dijenie se cila është gruaja brenda asaj karroce që kishte ardhur në Rrafsh. Por Gjorgu e di se vrasja mund t’i vijë tani vetëm nga fisi i Kryeqyqëve, por dhe e di se pas atij xhami në karrocë ishte një jetë tjetër. Edhe përkundër rrezikut, Gjorgu vendos t’ia kthejë shpinën frikës edhe pse ishte jashtë besës, nxiton ta takoj sërish atë vështrim të gruas misterioze. Këto tridhjetë ditë të sigurta të vdekjes, Gjorgu arrin t’i rikthejë në ditë të lumtura që nuk i kishte përjetuar asnjëherë më parë në Brezftoft.

“*I pari është nisur të paguajë tagrin e gjakut- e dyta të njohë tagrin e gjakut; një burrë dhe një grua- sinonim i jetës*” (JETA P. V. NGA VDEKJA, 2022). “*Të dy takohen atje ku s'mundet njeriu, por mundet vetëm dashuria*” (JETA P. V. NGA VDEKJA, 2022). “*Një kryqëzim, në një vend vetëm me shumë gjak e pak fjalë, mjafton një shikim i vetëm*” (JETA P. V. NGA VDEKJA, 2022).

Takimi mes këtyre dy të rinjëve ishte në një bujtinë. Diana ishte me të shoqin ku dhe aty takuan Binak Alinë, ai ishte njeriu që i pajtonte njerëzi që ishin në hasmëri mes veti. Përveç Binak Alisë, aty rastësisht takuan dhe Gjorgun. Besiani e pyeti se si quhet, se e njohu nga rripi që mbante dhe se ky ishte në gjak. Ai ia ktheu përgjigjen dhe vazhduan rrugëtimin të dyja palët. Ai i tregoi Dianës se ky është në gjak. Ky takimi mes Gjorgut dhe Dianës që mbresëlënës sepse ajo kurrë më parë nuk kishte parë, nuk kishte ndier diçka kaq të fuqishme në zemrën e saj dhe ishte tronditur nga ai vështrim i Gjorgut. Gjithë udhëtimin që e bënë gazetari Besian Vorpsi dhe Diana, ajo mendjen e kishte te Gjorgu dhe herë- here pyeste diçka për hakmarrjen dhe zakonet. Për Gjorgun udhëtimi për në shtëpi dhe besa që i kishte përfunduar e çonin në shumë mendime, por njëra ndër to ishte për Dianën, të cilën nuk mund ta hiqte nga mendja. E mendonte dhe karrocën e zezë me kadife, derisa është ndalur në një bujtinë ai aty dëgjonte për atë karrocë. Çdo ditë e kërkonte, por sa binte në gjurmë, e humbte.

“*Takimi për këta të dy ishte shpresë sepse ata të dy donin ta takonin përsëri njëri- tjetrin edhe pse kjo ishte e pamundur*” (JETA P. V. NGA VDEKJA, 2022). “*Por takimi është pikërisht në atë mbretëri fantastike dhe ajo s'mund të jetë veçse shikim, imagjinatë, ndërsa ai*

një "Hamlet i zi", i parë atje ku ditët e jetës maten me "metrin e vdekjes" (JETA P. V. NGA VDEKJA, 2022).

Një dashuri që donte shumë sakrificë, sepse për njërin kishte jetë para e tjetri jetonte ditët sikur të ishte e fundit. Ndoshta ky takim mund edhe të quhet jetë a vdekje!

3.1.4 LINDJA E DJALIT

Pasuria më e madhe që Zoti i jep prindërëve është fëmija. Dhuratë që s'ka çmim. Si vajzë si djalë lindja e tyre është pasuri. Ne si popull lindjen e djalit e duam më shumë. Pse? Sepse prindërit janë të sigurt që ka kush të kujdeset për ta në momentin që plaken dhe kanë trashëgimtar. Tani edhe pse kanë ndryshuar kohërat, edhe pse dëshirojmë të bëhemi si evropian, nuk mundemi, se përsëri lindja e djalit ka gëzim më të madhë se e vajzës. Për vajzat mund të themi se më shumë ndjejnë keqardhje. Këtu mund të themi se nuk janë të këtij mendimi. Një lindje e djalit te shqiptarët si popull është një krah. Gëzim i madh në një familje shqiptare ka qenë pritja e një fëmije e sidomos ajo e gjinisë mashkullore. Një lindje e djalit sipas kanunit të popullit tonë duhet të merrte gjak, pra me lindjen e djalit menjëherë mendohet dhe vdekja. Kjo ishte në pjesën e Shqipërisë së Veriut, ku dhe aty e shkruan ngjarjen autori. Siç dihet me Kanun vetëm gjinia mashkullore është në gjak. E sidomos kjo më së shumti është vërejtur në Shqipërinë e Veriut, kryesisht në Mirditë në vitet e '30-ta ku autori e shkruan romanin „Prilli i thyer“, thonin kur lindte djali *“me jetë të gjatë e ta vraftë pushka”* (F. gjeri, 2022), ky ishte urimi i lindjes në Rrafsh. Autori shkruan gjakmarrjen e familjes Berishaj me atë të Kryeçyqeve, që kishin pasur 44 vrasje mes veti, me këtë shembull kuptohet se sa lindje janë bërë, e është ditur vdekja e tyre.

Ky lloj urimi i fëmijës mundemi të themi që ka formën e intertekstualitetit.

Në çdo vepër letrare është përmendur vdekja, pra ka vdekje, dashuri po në këtë roman para se të lind fëmija, e ka të përcaktuar vdekjen. Pra, vdekja e fëmijës është e shkruar sipas zakonit kanunor, pra kjo mund të quhet si vdekje e paramenduar.

“Vdekjet në letërsi janë të papritura dhe të parathëna” (JETA P. V. NGA VDEKJA, 2022). *“Ka vdekje natyrale, nga lufta, vetëvrasje apo nga një plagë”* (JETA P. V. NGA VDEKJA, 2022). *“Por, asnjë nuk ngjan me vdekjen që sugjeron Prilli: akti i vdekjes është shkruar më parë se akti i lindjes”* (JETA P. V. NGA VDEKJA, 2022).

3.1.5 VRASJA E FOSHNJËS

Një vdekje e një foshnje, është për të ardhur keq, por një vdekje që e bënë me mendim të vetëdijshëm është një krim i madh. Krijesa më e pafajshme në botë, të mbytet ende pa u zhvilluar në barkun e nënës mund të quhet rast makabër. Por kjo vrasje në Rrafsh nuk ishte edhe aq tragjike, edhe pse ky fëmijë ishte jashtë kurore asnjëherë s’duhet të ishte bërë kjo që iu bë nënës dhe foshnjës.

Një vajzë e mbetur shtatëzënë pa kurorë. Familjarët e saj e kuptuan që ajo ishte shtatëzënë dhe e vranë. Ata e vranë që mos të turpërohen. Mendimi i tyre ishte që ta vrisnin edhe djalin.

Familjarët e djalin marin vesh se vajzën e kanë vranë dhe poashtu dhe foshnjën që e mbante në barkë e që ishte djalë. *“Ajo familje, pra e djalit i kërkonte gjak familjes së vajzës, edhe pse djali i tyre nuk kishte kurorë me vajzën, ata lypnin gjak për shkak të foshnjës mashkull”* (I.K., 2022). Familja e djalit e shpalli gjakun për ta marrë, pra rradhën për të vranë nga familja apo fisi i vajzës.

Ata donin që ta mbronin djalin e tyre edhe pse ishte fajtor. Familja e vajzës ishin në kundërshtim me këtë që po bënin ajo familje. Pasi që këto familje nuk mund të mereshin vesh mes veti, ata ftuan pleqësinë e katundit.

Siç dihet, foshnja mashkull në barkun e nënës kërkon gjak pra është njësoj sikur vdekja e një burri. Pleqësia e katundit e kishin të vështirë se çfarë të vendosnin dhe ata ftuan Binak Alinë.

Një përfaqësues i familjes së djalit i ishte drejtuar Binak Alisë: *“Desha të di, përse ma derdhën atë miell (domethënë foshnjën e palindur)”* (JETA P. V. NGA VDEKJA, 2022). *“Binak Alia i ishte përgjigjur aty për aty: Ç`donte mielli yt në thes të huaj? (domethënë në barkun e vajzës se huaj, pa kurorë)”* (JETA P. V. NGA VDEKJA, 2022).

Nga ky mendim i Binak Alisë të dyja palët dolën të lara, nuk mbetën në gjak në mes veti.

Mund të themi që me gjestin fisnik që e bëri një njëri nuk pat gjakmarrje mes këtyre dy familjeve. U liruan të dyja familjet edhe pse kishte dy vdekje të menjëhershme. Por këto vdekje u bënë për të mos e turpëruar familjen e vajzës.

3.1.6 NJË VRASJE E DËSHTUAR

Në mes të familjeve që ishin në hasmëri në mes veti kishte pasur shumë vrasje, por një tentim për vrasje i kishte shkuar huq Gjorgut, i cili e kishte plagosur një anëtarë të familjes së Kryeçyqëve.

Ishte hera e parë për Gjorgun që kishte gjuajtur mbi hasmin, nga kjo gjuajtjeje mbeti i plagosur. Nga kjo plagosje familja Berishaj kishte shkuar vetëm në humbje dhe ishte e dërrmuar ekonomikisht. Gjendja ekonomike edhe më shumë e kishte rënduar Gjorgun.

Nga kjo vrasje apo ndryshe mund ta quajmë tentim vrasje, Gjorgu kishte ndjer për gjakësin keqardhje dhe turp.

Kjo plagosje nga ana e Gjorgut kishte ndodhur gjashtë muaj para se të ndodhte vrasje, që iu bë Zef Kryeçyqës. Ai, pra Gjorgu kishte frikën që mos të ndodhte edhe një herë, sepse familja e tij edhe më shumë do të shkatërrohet.

Ky veprim i Gjorgut, e mësoi atë se si duhet të luftoj e mos të vie deri te plagosja tjetër dhe ta kryente obligimin sipas kanunit, pra të bënte vrasjen, edhe pse ai nuk ishte që të vazhdonte gjakmarrja. Ky zakon kanunor sipas traditave mbarëkombëtare ekziston vetëm te populli shqiptar. Disa tradita që edhe autori i përdor në këtë vepër letrare. Siç shihet në shumicën e rasteve janë të përdorura tradita dhe disa forma të intertekstualitetit siç është p.sh.më e shpeshta aluzioni dhe citimi.

3.1.7 PAS VRASJES, ÇFARË MENDOI GJORGU ?

Gjorgu pasi i bëri të gjitha obligimet që i kishte sipas zakonit, u kthye në shtëpi me 25 mars. Nga ky kthim ai pa një baba të qetë dhe një nënë të mjegulluar. Gjorgu donte vetëm të flinte dhe të qetësohej, por mendimet i kishte ngado. Si çdo njeri kur e bënë një veprim dhe nga ai veprim apo gabim ta quajmë dëshiron që të mësojë edhe për Gjorgun ishte kështu. Megjithëse për vendin ku jetonte dhe rrethin që e rrethonte ky nuk ishte gabim, ai veprim ishte obligim.

Mendimi i parë që i vie Gjorgut ishte se si do të mbarojë besa që e kishte deri më datë 17 prill, e cila tani më dy javët e para i kishte kaluar. Ai e quante këtë besë apo këtë pjesë të jetës prillmort.

Mendimi tjetër ose mundësia për të jetuar e Gjorgut ishte, si e të gjithë malësorëve të Rrafshit që ishin në gjak, ishte të bëheshin druvar shitës, por këtë mendime nuk ia tha askujt. Babai i tij që e shikonte e ndjente diçka, si çdo prind që ka dashurinë për fëmijën e tij edhe

babai i Gjorgut kishte dashuri për atë, por tradita kanunore duhet të vazhdonte. Para dashurisë prindërore kuvendonte kanuni. Babai nuk dëshironte që dhe jeta e Gjorgut të përfundonte si e Mëhillit. Ai ia dha disa të holla dhe e përshëndeti, por i tha që asnjëherë nuk duhet ta harrojë ditën e fundit të besës. Ai kishte besën tridhjetëditëshe, e cila në popull njihej si besa e madhe.

Tani për Gjorgun po fillonte një kapitull i ri, rrugë të reja, njerëz të ndryshëm etj. Deri sa udhëtohe sa në një bujtinë e në tjetrën, një ditë në një bujtinë të quajtur Hani i Ri, aty dëgjonte të flitet për një karrocë të bukur. Aty flitej për Dianën, për atë femër të bukur nga qyteti. Ai nga këto që dëgjoi harroi se për çfarë ishte nisur. Asnjëherë nuk e çoi deri në fund këtë punë, sepse filloi duke e kërkuar karrocën kadife, dëshironte që dhe një herë ta takonte atë femër të bukur.

3.2. METAMORFOZA E GJORGUT

“Nga një fshatar i thjeshtë, pa shumë dije, jashtë Kullës dhe Kanunit, ai kthehet në një Hamlet malesh, Princ” (JETA P. V. NGA VDEKJA, 2022). *“Kur i ndodhi ky ndryshim?”* (JETA P. V. NGA VDEKJA, 2022).

Kjo i ndodh në një kryqëzim. Atje ku shpirti dhe fati bëhen bashkë. Nga këtu Gjorgu nuk e ndjente vetën në gjak, ai tani ndjente një ndjenjë tjetër. Atë ndjenjë që kurrë më parë nuk e kishte ndjerë.

3.2.1 METAMORFOZA E DIANËS

Në vepër është ajo, Diana që i thyen kufijtë, ajo edhe pse e adhuron të shoqin, por bashkëjetesa mes tyre i duket e pamundur.

Ajo na del një personazh si në librat përrallorë dhe provonë fantazinë duke tentuar që në zemrën e saj të hyjë një malësor i panjohur, që ishte gjakës. Kështu kjo me këto veprime donte ta lidhte të padukshmen me të dukshmen, jetën dhe vdekjen.

Ishte Diana ajo, e cila ishte një vajzë që vinte nga jeta urbane, dhe ishte kjo që theu kufijtë që një femër të vijë në Rrafsh.

“Edhe pse në fillim të veprës, dukej se Diana është një nga personazhet dytësore të romanit, në shtjellimin e mëtejshëm të veprës ajo na del si një nga personazhet kryesore (letërsi ekzistencialiste), ku njeriu merr në dorë fatin e tij për të vendosur se çdo të bëjë me të, edhe pse ky fat ndonjëherë e dërgon drejt vdekjes.” (Q. I., 2022)

Këtu Besian Vorpsi na del një njeri me një diapazon të gjërë, përveç se është shkrimtarë ai ka njohuri edhe për historinë dhe traditat shqiptare. Ai Kanunin e Rrafshin e njohu nga librat e lexuar dhe nga kjo zotësi i bëri edhe të tjerët t’i shihnin këto me sytë e tij.

Përballë Dianës ka qëndruar një djalë i ri, i cili u quajt Gjorg, vinte nga një botë ndryshe, nga ajo e Dianës, rruga e tij, pra Gjorgut ishte e përcaktuar më parë.

Diana ishte një vajzë e re nga qyteti që rruga e saj ishte fati. Nga këta dy të rinj kemi dy rrugë të ndryshme njëri rrugën e fataliteti e tjetra të fatit.

Në prag të vdekjes pak rëndësi kishte se nga cila rrugë vjen. Nga jeta e këtyre të rinjve s’kishte mbetur të shfaqet asgjë, përveç vdekjes.

Ata mendonin vetëm vdekjen, ajo vdekja ishte sfida e jetës për Dianën dhe Gjorgun. Jeta e tyre ishte se për çfarë jetuan, çfarë kuptimi pati jeta për ta, ishin vetëm këto mendime që iu shkonin në mendje.

Kulla ishte pritja e atyre që ishin në besë e që duhet bërë tagri i pagimit të gjakut, atje mund të jesh në besë, por brenda një vdekje. Nëse atje të rrespektojnë për ato 24 orë apo edhe për ato 30 ditë, pra besa e madhe. A ka vlerë jeta më tutje? Vlera e jetës nuk matet me asgjë, deri në momentin që na bie diçka për ta vlerësuar jetën ashtu si duhet.

Diana në kullën e Ngujimit, është ngujimi për jetën, ishte e interesuar të dinte se si vazhdon jeta pas asaj kulle. Pse u fut Diana në atë kullë? U fut sepse rrahjet e zemrës tani për atë ndryshuan, kishte aty si e quante ajo një “ princ të zi”. Ky motiv e detyroi atë të futet në kullën e Vdekjes.

Përveç Gjorgut dhe Dianës përballë fatit dhe vdekjes, ishte Besiani. Besiani ishte një njeri i shkolluar i ardhur nga qyteti, ishte shkrimtar i njohur ashtu si e përshkruan autori, ishte dhe një lexues i mirë. Kur themi ishte një lexues i mirë e them për arsye se e njohu Kanunin e Rrafshit prej leximeve që i kishte bërë.

Në tjetër temë që meriton vëmendje është edhe ajo e vdekjes. Një e vërtetë e hidhur, ishte ajo e urimit të lindjes së djalit në Rrafsh.

Kjo e vërteton se në një kapitull të jetës kemi certifikatën e lindjes dhe në tjetrën certifikatën e vdekjes.

“Në momentin që lind një fëmijë (mashkull) në Rrafsh urime ishte: Me jetë të gjatë e ta vraftë pushka” (gramhir, 2022)

Edhe pse dihet që vdekja është e pashmangshme në letërsi, urimi i lindjes dhe vdekjes në Rrafsh ishte urim i zakonshëm.

3.2.2 PRANIMI I REALITETIT

“Mos vallë rikthimi i Dianës në të njëjtën karrocë me Besianin është një pranim i realitetit, një nënshtrim të asaj që duhet” (JETA P. V. NGA VDEKJA, 2022). “Pra, mos vallë na fton që pas ëndrrës duhet të zbresim me këmbë në tokë? Mos vallë instikti i gruas fitoi mbi ëndrrën?” (JETA P. V. NGA VDEKJA, 2022). “Mos vallë një jetë e sigurtë e mbyt edhe zjarrin më të madh të dashurisë, kur kjo dashuri nuk është atje ku e kemi menduar?” (JETA P. V. NGA VDEKJA, 2022).

Për Dianën ishte një ëndërr e dështuar, kishte menduar të kishte pasur një realitet ndryshe në Rrafsh. Diana e pranoi një realitetit pa dëshirën e saj, sepse jeta e kishte sjellë në një realitet ndryshe. Kishte pasur një instikt që atje do të takonte njerëz të ndryshëm e me një jetë ndryshe, ashtu si kishte ëndërruar që këtë muaj mjalti do ta kalonte si është më së miri, e asnjëherë nuk e kishte menduar se do ta gjente një Rrafsh ndryshe.

Instikti i gruas nuk mendoj që ka fituar mbi ëndrrën, sepse ajo kishte pasur një ëndërr ndryshe. Ajo dashuri që asnjëherë se kishte jetuar, mund ta quajmë që kishte qenë një dashuri e dështuar.

3.2.3 PRANIMI I DASHURISË NGA GJORGU

Mos vallë dashuria njih rregulla? Në dashuri nuk ka rregulla, ajo vjen në momentin që nuk mund ta mendosh. Për Gjorgun, ta mendonte dashurinë në këtë kohë ishte e papranushme, pse? Ai kishte tani një jetë që mendonte se si ta jetonte edhe këtë muaj që i kishte mbetur, te dashuria asnjëherë nuk i kishte shkuar mendja, e sidomos në atë Rrafsh ku gjakëmarrja ishte jetë primare.

Dashuria nga ana e Gjorgut pranohet në një vend ku ata e kalonin natën, kur mbeteshin në rrugë nga aty ndëgjoi të flitet për karrocën e famshme të çiftit Vorpsi. Ajo ishte një karrocë nga qyteti. Aty flitnin disa burra për një grua të bukur, me sy të gështenjtë. Ai e kuptoi se për kë ishte fjala. Shikonte e vështronte sa andej e këndeje se nga t’ia mësyjë, që ta shihte edhe njëherë atë grua të bukur.

3.2.4 TRADITA PËR VRASJE

Në jetë njeriu ka shumë sfida, disa janë më të vështira e disa më të lehta. Jeta ka shumë sakrifica, por sakrifica më e madhe në këtë roman mund të themi ishte që Gjorgu bëri për vete, sakrifikojë jetën e vet për familjen e tij.

Në veprën “Prilli i thyer” dhe në librin e ligjit të shqiptarëve ,Kanunin, jeta është e shenjtë. Pse? Se çdo fëmijë që lind mund të themi që e ka të ditur se si do ta jetojë jetën. Në “Prillin e thyer” autori përshkruan jetën e një malësori të ri, i cili kishte jetën përpara por gjakëmarrja e detyroi që ëndrrat e tij të ndalen në mes. Gjakëmarrja ka ekzistuar te shqiptarët që nga kohërat e hershme poashtu edhe sipas kanunit gjakëmarrja duhet të lahet me gjak, ashtu siç e përmend edhe autori në veprën “Prilli i thyer”.

Në gjakëmarrje pra dihet që merrnin pjesë vetëm gjinia mashkullore. Si është edhe në veprën e Kadares te” Prilli i thyer” dhe në Kanun të Lekë Dukagjinit “*Shqiptari e merr gjakun veç me pushkë e, ndryshe, s’guxon*” (ese, 2022). “*Thikën, gurin, konopin e gjithçka tjetër që s’nxjerr zjarr e s’bën zhurmë që larg, kanuni nuk i njeh*” (academia, 2022).

Pra, kanuni e donte që të merret gjaku vetëm me pushkë. Në ato 44 vrasje që ishin bërë mes këtyre familjeve, që të gjitha ishin bërë ashtu siç e donte zakoni me pushkë.

3.2.5 PAJTIMI MES KËTYRE DY FAMILJEVE

Te romani në fjalë pra, “Prilli i thyer” shumë herë Gjorgu gjindet në mendimet e tij, se si nuk dëshiron që ta merrte gjakun.

Për pajtimin e këtyre familjeve ishte një grua, e cila ishte halla e familjes së Berishajve, e cila kishte ardhur nga një vend i largët, që atje ishte e martuar. Ajo ishte e shqetësuar sepse Gjorgu ishte mashkulli i fundit në familje dhe babai i tij. Për këtë shqetësim ajo erdhi sepse më në këtë familje s’do të mbetet asnjë mashkull, e kishte frikën se më nuk do të ripërtrihet familja e saj, pra më nuk do të ketë pasardhës.

Ajo kishte ardhë që këto dy familje të e falin gjakun mes veti, pra të ketë pajtim, por asnjë nuk ia vuri veshin se çfarë fliste ajo, sepse ishte e kundërligjshme mosmarrja e gjakut. Ajo ecte derë më derë nëpër familjen e vet për ta kërkuar këtë të mirë për të gjithë, boll ishin bërë vrasje me këto familje.

Kërkesa që e bëri halla ishte e papranushme, se ishte kundër dëshirës dhe kundër ligjit. Mirëpo, kjo kërkesë u bë shumë e madhe në Malësi, se ishte e pazakont, por edhe e kërkuar nga një grua që ishte shumë pak e pritshme, por e morën parasysht ndërmjetësit e pajtimit.

Ndërmjetësit ftuan familjet që të marrin pjesë në këtë takim, aspak të zakonit, por që kishte rëndësi të madhe sepse ndryshonte shumë jetët e atyre njerëzve. Në takim u paraqitën të dy familjet dhe gati sa ranë dakort që gjakun ta falnin, por një plak i familjes së Berishajve ishte kundër dhe hasmëria në mes këtyre vazhdoi.

Mendimi që pati halla ishte mendim pozitiv për të dyja anët, por kjo nuk ndodhi.

Mund të themi që ky ishte mendimi i parë dhe i vetmi në këtë vepër ishte i të mirë të të dyja familjeve të Berishajve dhe Kryeqyqëve.

Gjendja në të cilën gjendeshin familjet, veprimi i hallës ishte një qetësim i shpirtit të tyre, pas një periudhe shtatëdhjet vjeçare që kishin, por kjo nuk ndodhi.

3.2.6 KAU I ZI

Rastësia është mbret i botës dhe kjo rastësi e këtyre dy malësorëve ishte kështu. Që të dy ishin në gjak, njërit i kishte kaluar besa tri ditë më parë, ndërsa tjetrit i kalonte në mesditë. Këta dy malësor i qanin hallin njëri-tjetrit, bile ai që e kishte kaluar besën këto tri ditët e fundit kishte pasur për ta shitur një ka. Nuk kishte mundur që ta shiste e shpresonte që ta shiste tani që i ka kaluar besa, se nuk kishte kush t'ia shiste më. Mendojë që ky ka simbolizonte një vdekje, e ajo vdekje mund të ishte jeta e Gjorgut, në bazë të asaj se çfarë bisedojnë këta të dy mes veti. Ky malësor që i kishte kaluar besa tri ditë para në bisedë e sipër me Gjorgun i tha se duhet me patjetër ta shesë, por duhet që të shkonte në rrugë të sigurt. E ato rrugë të sigurt ishin të pakta se ato duhet të ishin në besë.

Ato rrugë apo si i përdorë autori “udhë” janë e veçanta e kësaj vepre, ai përmend aq shumë rrugë e vështirë është për t'i mbajtur në mend, siç janë: Udha e Flamurëve, Udha e Hijes, Udha e Kryqit, Udha e Madhe etj.

3.2.7 GJAKMARRJA PJESË E JETËS SË SHQIPATËRVE

Shqiptarët si popull njihen që janë mirëpritës dhe të besës. Ashtu si e ka Kanuni, por edhe në veprën e Kadares këto dy tema janë temat kyçe. Por duke mos lënë anash edhe procesin e gjakmarrjes, që në kohërat e hershme ka qenë shumë e përhapur.

“Kjo gjakmarrje shënon një epokë ku shteti nuk i detyronte ligjet e veta ... e rridhte nga një kod shumë i përpiktë, që nuk linte asgjë në hije ... në zonën e kanunit e drejta e vetëgjyimit nuk ekziston” (idituri, 2022)

Gjakmarrja është hakmarrje në mes dy familjeve. Hakmarrja nënkupton veprimin e një individi apo disa njëjësve. Përgjegjësi për veprimin e një individi mban e tërë familja. Si ishte rasti i Gjorgut që duhet të merrte gjakun, se veprimin se mbartë vetëm një, por e tërë familja.

Dihet që Kanuni është një libër i vjetër *“dhe i ka ligjet e veta, edhe pse dihet që ky libër më herët ka pas një përdorim më të madh te populli jonë, kohën e sodit ka zënë të lihet pas dore, jo pse nuk është i rëndësishëm, por më”* (Fat , 2022), shumë për gjakmarrjen. Gjithmonë do të ketë rëndësin e vet.

Edhe pse në disa popuj, ne shqiptarët mund të konsiderohemi si të vrazhdë e të egër. Pse na konsiderojnë kështu? Sepse nga ato çka është dëgjuar për hasmërin e gjakmarrjen ata mendojnë se ne jemi një popull që vetëm vrasim.

“Fenomeni gjakmarrje, dhe mënyra se si është manipuluar, ka dëmtuar reputacionin e Shqipërisë dhe popullit shqiptar brenda Evropës dhe më gjerë” (Tryezë e rrumbullakët, 2022). *“Ka krijuar një përshtypje për shqiptarët si të dhunshëm dhe të rrezikshëm”* (Tryezë e rrumbullakët, 2022). *“Por neve që jetojmë këtu e dimë se kjo nuk është e vërtetë”* (Tryezë e rrumbullakët, 2022).

Gjakmarrja sipas kanunit është një procesë i gjatë, nga aty përfshihen njerëzi në konflikt.

“Familjet e ngjuara jetojnë në kushte të papërballueshme, duke u ballafaquar me mungesa të shumta të karakterit ekonomik, shëndetësor, edukativ etj” (GJOKA , 2021). *“Më të prekurit në këtë rast padyshim janë gratë dhe fëmijët, si pjesa më e pa mbrojtur e shoqërisë”* (GJOKA , 2021). *“Gratë në familjet e ngjuara nga gjakmarrja janë viktimat e vërteta të saj”* (GJOKA , 2021). *“Ato megjithëse janë “të lira” pasi zakoni dhe kanuni nuk lejon vrasjen e tyre për gjakmarrje, janë pjesë më e persekutuar dhe e dhunuar e familjes”* (GJOKA , 2021).

Ato janë të detyrara t`i kryejnë të gjitha punët pasi që gjinia mashkullore janë të ngjuar në shtëpi.

Në kohërat e hershme ky fenomen ka qenë shumë i përhapur, njerëzit kanë qenë të etur për gjakmarrje dhe për kryelartësi. Pse e themi këtë? se ne jemi një popull që jemi gjaknxehtë, e gjaknxehtësia asnjëherë nuk të sjellë të mira. Pasi njerëzit kanë filluar të dalin e të ecin edhe nëpër vende tjera, kanë filluar të vetëdijësohen dhe kanë filluar t'i largohen gjakmarrjes si proces i rëndësishëm. Mendimi im personal.

Fenomeni i gjakëmarrjes është një fenomen shumë i përhapur e sidomos në zonën e veriut. Gjakmarrja është një fenomen i shoqërisë ku ligji nuk njih forcë. Kanuni i Lekë Dugagjinit është ai që i jep jetë gjakmarrjes. Ky fenomen çon në humbje çdo familje që është në gjak, poashtu dhe dëmton shumë ato familje.

“Ky roman madhor, që mund të shkruhej vetëm në Shqipëri dhe vetëm nga një penë fort e stërvitur dhe e guximshme si e Kadaresë, edhe pse ka leximin e vet universal, në një kontekst nuk ka përfunduar as sot” (Gj. i B. nëpër ravën e sh., 2022). *“Nëse ka rënë kulti i mikut dhe i besës, gjakmarrja, ndonëse në një terren atipik sa i përket Kanunit, vijon të shuajë aty-këtu jetë njerëzish, ku herë shtiejnë “Kryeqytë” e herë “Berishajt” e Rrafshit shqiptar kinse modern”* (Gj. i B. nëpër ravën e sh., 2022).

Ne populli shqiptarë kemi dy shtete shqiptare, Shqipërinë dhe Kosovën, njerëzit e këtyre shteteve kanë filluar dhe po mundohen të e heqin pjesën e gjakmarrje nga tradita.

Gjakmarrja si procesë ka vazhduar edhe në ditët e sotme, por me një eleminim të dukshëm. Gjakmarrjen në shumë raste, e sidomos në Kosovë bëhen pajtime vetëm që mos të derdhet gjak mes dy familjeve. Për shembull: mund të përfundojnë si te “Prilli i thyer” me 44 vrasje e 70 -vjet hasmëri në mes veti. Ky shembull i pajtimeve në Kosovë është për të mirën e popullit por dhe për rininë. Kur bëhen pajtimet për faljen e gjakun, në kohën e fundit i shohim dhe nëpër televizionet tona.

Mendoj që jepen nëpër televizione që njerëzit të vetëdisohen dhe të marrin shembull njëri-tjetrit për të mirë.

Për procesin e gjakmarrjes kam folur vetëm nga ato gjëra që i kam lexuar e dëgjuar.

3.2.8 THYERJA E RREGULLIT TË KANUNIT– DIANA

Në kanun ka shumë rregulla, por njëra ndër kryesorët dhe më të rëndësishmet është ndalimi i gruas në odën e burrave apo siç përdoret këtu në roman në kullë. Përveç kësaj rregulle ka edhe disa rregulla kanunore që janë për gratë. Rregullat në kanun duhet respektuar. Në këtë roman autori thyen rregullin që ajo të hyjë, sepse ajo hyri në kullë dhe shumica e atyre që ishin në kullë ishin kundër. Njëri që ishte kundër ishte edhe Mark Ukaçjerra dhe ishte tepër i nervozuar nga veprimi i princit. Gruaja që theu rregullin kanunor ishte Diana, një grua e bukur e ardhur nga Tirana në Rrafsh. Ajo kishte ardhur me bashkëshortin e saj Besianin, i cili ishte gazetar i njohur në kryeqytet. Pricni i cili çdo herë kur kishte ardhur ndonjë mysafirë në kullë, ai vetëm i kishte uruar mirëseardhje, atë natë që erdhi Diana ai s’kishte pushuar së foluri. Për këtë arsye Mark Ukaçjerra ishte kundër

veprimin të princit i cili edhe kishte thyer rregullin kanunor në momentin që e la Dianën të shkel në kullë dhe për veprimin se si ai i kishte pritur. Me këtë veprim e konsideronte princin se ishte dorëzuar para një gruaje. Por ajo nuk ishte grua dosido ajo kishte një bukuri që të mahnite siç e përshkruante autori.

KAPITULLI I KATËRTË

4.1 ÇFARË EKZISTENCIALIZMI FUNKSIONON NË RRAFSH

Çfarë është ekzistencializmi?

Fjala ekzistencializëm vjen nga fjala ekzistencë. Nga fjala ekzistencë ne kuptojmë jetesën e një populli se si jeton dhe çfarë jete bënë. Ekzistenca e një populli tregon se çfarë jete ka bërë një popull apo njerëzit në një vend. Në këtë vepër letrare autori flet për jetesën e popullit në krahinën e veriut të Shkodrës, gjegjësisht Rrafshit, ku jeta aty ishte e konceptuar vetëm në bazë të kanunit.

“Megjithëse shpesh trajtohet si një shkollë filozofike e mendimit, do të ishte më e saktë të përshkruhej ekzistencializmi si një prirje apo tendencë që mund të gjendet gjatë gjithë historisë së filozofisë” (Ç’është ekzistencializmi, 2022). *“Nëse ekzistencializmi ishte një teori, do të ishte e pazakontë në atë që do të ishte një teori që është kundër teorive filozofike”* (Ç’është ekzistencializmi, 2022).

Ekzistencializmi pasi është përdorur edhe si mendim mjaft autorë e kanë përdorur në veprat e veta si p.sh. Niçe, Kamy, Kafka, Dostojevski, Sartri etj. Ndërsa autorët shqiptarë ishin Isamil Kadare, Dh. Shuteriqi, S.Spase etj.

“Sisteme të tilla abstrakte kanë tendencë të errësojnë faktin se jeta është një çështje mjaft e ashpër dhe e rrënuar, shpesh shumë e çrregullt dhe problematike” (Ç’është ekzistencializmi, 2022). *“Për ekzistencialistët, nuk ka asnjë teori të vetme që mund të përmbajë gjithë përvojën e jetës njerëzore”* (Ç’është ekzistencializmi, 2022).

“Temat dhe idetë ekzistenciale mund të gjenden në një shumëllojshmëri të gjerë veprash gjatë gjithë moshës, nëse e dini se çfarë duhet të kërkoni” (Ç’është ekzistencializmi, 2022). *“Filozofët dhe shkrimtarët modernë që identifikohen si ekzistencialistë kanë tërhequr shumë rëndësi mbi këtë trashëgimi, duke e nxjerrë atë në vëmendje dhe duke tërhequr vëmendjen e njerëzve në të, në mënyrë që të mos lihen pa u vënë re”* (Ç’është ekzistencializmi, 2022).

Siç është rasti te “Prilli i thyer” i Ismail Kadaresë ku autori e përdor këtu ekzistencializmin e një pjese të Shqipërisë. Kjo është një pjesë ku identifikohet ekzistencializmi dhe që ka tërhequr vëmendjen e gjithë lexuesve shqiptarë dhe të huaj për temën që ka shtjelluar te kjo pjesë mund ta identifikojmë shumë lehtë, ndërsa ka disa tema që janë të përdorura por duhet t’i identifikojmë.

4.1.1 DIANA NË KULLËN E NGUJIMIT

Në Rrafsh funksiononte një ekzistencializëm ndryshe, kishin një jetë ndryshe nga ajo që njerzit e tjerë e jetonin në Shqipëri. Aty ekzistencializmi për jetë ishte sot për nesër, dhe gjithçka ishte e lidhur me kanunin. Jeta e tyre mund të ndryshonte brenda natës.

Ardhja e çiftit Vorpsi në këtë pjesë e ngjarjet që ndodhin aty të lëjnë për të dëshiruar.

Futja e Dianës në kullën e ngujimit ishte një gjest i madh dhe fisnik, se po të futeshe atje nuk mund të kthehesh mbrapa.

“Diana niset për në Kullën e Vdekjes, por kthehet nga andej si një udhëtare në Kullën e jetës” (JETA P. V. NGA VDEKJA, 2022).

“Kjo fitore e Dianës "që jetonte" mbi "Besianin që tregonte" është pikërisht edhe një përgjigje e pyetjes së mbetur pezull mbi purgatorin e ngritur në këtë vepër: Cila jetë vlen, ajo e gjata, apo ajo me kuptim?” (JETA P. V. NGA VDEKJA, 2022).

Për atë, Dianën tani më jeta kishte marrë tjetër kuptim, më e rëndësishme ishte ta kishte jetën të gjatë se nga ajo që shihte atje iu duke sikur jeta e saj shumë shpejt do të përfundojë.

Diana dëshironte që ta dinte se pas asaj kulle çfarë fshihet? Diana nuk e dinte se çka mund ta priste atje. Kjo dëshirë për t'u futur aty i erdh nga momenti që e takoi Gjorgun, me të cilin edhe ra në dashuri. Një dashuri e një malësori që ishte i humbur dhe një vajze nga qyteti e cila i mahnite me bukurinë e saj, njerzit.

Në momentin që e mori vesh i shoqi i Dianës, Besiani, që ajo ishte futur në kullë, Binak Alia e kishte ftuar priftin, ishte ai i vetmi që mund të futet atje. Besiani ishte brengosur për të shqen se e dinte se çka mund të ndodhte, e ndiente vetën fajtor pse e kishte sjellë në këtë vend. Nga frika se mund të ndodhte çdo gjë ai donte që të hynte në kullën e ngujimit, por aty afër pati shumë njerëz dhe nuk e lane që të afrohet shumë pranë kullës sepse mund edhe të vritet. Tërë këto momente i ndodhën deri në momentin që erdhi prifti, por Diana vetëm sa kishte dalë nga ajo derë e mallkuar e kullës. Ishte bërë e gjitha e verdhë, Besiani e kapi nga krahu dhe u larguan.

“Përse shkove atje, thirri atëherë pa zë” (yumpu, 2022) *“Për të parë sa e tmerrshme ishte drama? Për hakmarrje ndaj meje?”* (yumpu, 2022).

Ajo mund të ishte një dramë me përfundimin tragjik për atë arsye edhe Besiani ndihet i nervrikosur nga ky gjest i Dianës. Kur ja bënë pyetjen për malësorin Gjorg, ai ishte i sigurt se vetëm për atë ajo mund të kishte shkuar atje në atë kullë.

Ata nga ky vend u larguna disa ditë më vonë, në ditën kur Gjorgun i kalonte besa tridhjetë ditëshe, pra me 17 prill. Kjo mund të ishte një rastësi se si e përdor autori nga dita kur ata largohen mu në atë datë. Gjaku i Gjorgut tani më vendoset përbalë dashurisë. Edhe pse ai e dinte që mund të vritet nga çasti në çast, ai jetonte një jetë tjetër.

“Diana, që vjen si hije, që nisët si spektatore, i nxjerr të gjithë nga skena” (JETA P. V. NGA VDEKJA, 2022). *“Të gjithë dilemën ajo e fut në një prej kullave të ngujimit, e del prej andej e vendosur për t'i dhënë kuptim ndjenjës, jetës”* (JETA P. V. NGA VDEKJA, 2022).

“Ajo i lidh të dy këta rrathtë të ekzistencës, për t'i dhënë zgjidhje asaj që duhet të bëjë kushdo - të guxojë të jetojë kudo, sepse vetëm të guxosh të jetosh përmes dashurisë, ia vlen” (JETA P. V. NGA VDEKJA, 2022).

Një grua në kullën e ngujimit ishte simbol i mirësisë dhe dashurisë, ajo për dashurinë hyri në kullën e vdekjes. Nga ky veprim i Dianës, kuptohet që ajo e pranoi dhe vdekjen për Gjorgun.

“Në fund, Gjorgu arrin t'i kthejë tridhjetë ditët e vdekjes së sigurtë, në ditë jete” (JETA P. V. NGA VDEKJA, 2022). *“Ai arrin të takojë atë që i kish munguar dhe në fund, në peshore, tridhjetë ditë rezultojnë më vitale, më të gjalla se e gjithë jeta e mëparshme”* (JETA P. V. NGA VDEKJA, 2022).

4.1.2 SI NDIHET BESIANI NË RRAFESH

Besiani një intelektual i njohur, që vinte nga Tirana. Ai besonte se ky udhëtim me të dashurën do të jetë ndër udhëtimet më të mira në jetë. Po nga ato që shohim gjatë udhëtimit fillon të mendojë se si do t'ia kalojnë. Ata kishin vendosur që muajin e mjalit ta kalojnë në Rrafsh.

Sapo futen në Rrafsh aty i shoqi i Dianës fillon që t'i flasë asaj për rregullat kanunore në këtë pjesë të Shqipërisë. Besiani e kishte siguruar që të shkonte gjatë këtij udhëtimi në Kullën e Princit, por deri sa arriti atje atij iu desh që të kalonte natën në disa bujtina tjera. Në ato bujtina takonte njerëz. Nga ata dëgjonte lloj- lloj ngjarje e muhabeti, e Diana vetëm se i dëgjonte, për të cilën këto ishin të paimagjinushme. Ajo për herë të parë shihte njerëz që ishin me sy të kuq e gra të rraskapitura nga puna. I shihte kështu sepse aty ku gjinia mashkullore ishin të ngjuar në shtëpi, gratë dilnin që të punonin. Por kishte edhe disa njerëz që ishin të lodhur nga ajo jetë me shumë sakrifica që bënin për jetën.

Ajo vetëm shikonte nga ato që shihte aty në Rrafsh, ajo e kishte menduar si një vend tjetër. Ishte një udhëtim i pazakontë nga i cili kishte përjetuar disa ngjarje që më parë nuk i

kishte menduar se mund t'i ndodhin p.sh. ardhja në Rrafsh, futja në kullën e ngujimit etj. Mund të themi se ky udhëtim për atë ishte një vdekje. E nga gjitha këto që ndodhën, Besiani shpeshherë e kishte ndier vetën keq pse e kishte sjellë në këtë pjesë Dianën, nga edhe e humbi përgjithmonë.

Një dashuri se mendohet që ka ekzistuar dhe humbi në momentin që ajo erdhi në këtë Rrafsh të malluar.

4.1.3 SI KISHTE NDODHUR GJAKËMARRJA MES KËTYRE FAMILJEVE

Gjakëmarrja me këto familje kish ndodhur me ardhjen e një miku në shtëpinë e Berishajve. Kishte qenë një natë tetori, kur në shtëpinë e Berishajve kishte trokitur në portë një njeri i panjohur. Gjyshi i Gjorgut e kishte future brenda, se s'kishte ku të shkonte se nata e kishte zënë në rrugë. Për të mos e kthyer mbrapa të panjohurin ashtu si e donte zakoni miku edhe në orët e vonshme po të vinte duhet të mirëpritet, ashtu siç e kemi ne shqiptarët këtë traditë. Atë natë ai kishte qëndruar aty në shtëpinë e Berishajve dhe të nesërmen herët e përcjellin deri aty ku i takonte për ta përcjellë mikun. Në atë moment që e lanë mikun te kufiri i fshatit, u dëgjua një krismë, kur u dëgjua kjo krismë familja e Berishajve u tmerruan. Pse? *“Në qoftë se e përcolle, i ktheve shpindën dhe në atë çastë miku u vra, ti je larë nga gjaku...”* (Ese, 2022).

“Përcjellësi kishte kthyer shpindën kur miku u vra, pra, i vrari nuk binte mbi të” (F. ab, 2022).

Nga kjo vrasje e mikut të panjohur mbeti kjo gjakëmarrje mes këtyre familjeve Berishajve dhe Kryeqyqëve.

I gjithë fshati ishin të tronditur nga kjo vrasje që kishte ndodhur, në një mëngjes të hershëm dhe se nuk dihet as kush ishte vrasësi, e si do të gjindet ai. Anëtarët e familjes së Berishajve këtë vrasje nuk e pritën mirë, se tani më jetët e tyre do të marrin tjetër kuptim. Graria ishin ato të cilat i pasonin pasojat, edhe pse ligji nuk i prekte, se jeta e tyre ndryshonte nga momenti në moment dhe jetët e të tyre do të jenë në rrezik.

Mirëpo kjo vrasje ishte e planifikuar nga dikush tjetër, kjo familje që e mirëpriti këtë mysafirë të panjohur, ishte një familje e pafajshme, ajo as nuk kishte pasur hasmëri ndonjëherë me ndonjë njeri më herët. Mikpritjen që ia bën mikut të panjohur, ia bënë ashtu si çdo shqiptarë që ia bënë me dashamirësi kudo.

Çdo gjë në jetë e kemi të caktuar. Caktimi që na ka bërë Zoti vetëm ai e di, e kjo vrasje ishte caktim që ndodhi ashtu.

4.1.4 VDEKJA E NATYRSHME NË RRAFSH

Vdekja është pjesë e jetës. Në shumicën e veprave letrare gjendet vdekja, aty mund të ketë vdekje të ndryshme si p.sh. vdekja me vrasje, siç ishte rasti i Gjorgut , vetëvrasje, vrasje aksidentale etj. Çfarë vdekje është në Rrafsh? Vdekja në Rrafsh ishte e natyrshme mund të themi në momentin që lind fëmija i urohet edhe jeta dhe vdekja. E quajtmë kështu sepse për ata ishte normale kjo vdekje. Urimi i zakonshëm në pjesën e Rrafshit ishte “*me jetë të gjatë e ta vraftë pushka!*” (f. Gjeri, 2022), ishte urim për fëmijën mashkull, ky ishte edhe formë e urimit dhe të mallkimit në pjesën veriore të Shqipërisë, që përmbante edhe llojin e vdekjes.

Urimi i cili i bëhet në Rrafsh ishte si lloj ligji sepse me atë urim konsiderohet që ai fëmijë u rrit si një burrë fisnik dhe jetojë si një njeri si e do ligji dhe kanuni.

Në Rrafsh, nderi vendoset nga Kanuni, dhe zemra e Kanunit është gjaku.

4.1.5 GJORGU DHE DIANA NJË NGJYRË NDRYSHE E KËTIJË ROMANI

Ata ishin dy të rinj që fati i solli në këtë pjesë të jetës. Njëri e kishte të caktuar para se të lindte vdekjen e tjetri e përjetoj vdekjen në Rrafsh.

Hasmëria që ishte në Rrafsh, i bënte njerëzit që të jetonin një ditë sikur të ishte e fundit. Ëndërra e vetme e Gjorgut ishte që ta shtynte sa më shumë momentin e vdekjes. Ai ishte një i ri që lindi në një kohë të përzier me gjak.

Ai edhe pse ishte kundër zakonit kanunor, vazhdonte të kryente ato obligime vetëm për hir të babait, që ai mos të ndjehet keq.

Diana një grua e fuqishme, që përfaqësonte bukurinë. Ishte një grua që shpresonte një të ardhme të mirë në Rrafsh, e asnjëherë nuk e kishte menduar se Rrafshi mund të ishte ashtu siç e përshkruan autori. Ishte ai Rrafsh ndryshe nga se kishte lexuar nëpër libra. Nga ajo që pa aty Diana u shqetësua, nga kulla, vendi, ngjarjet, etj. Për Dianën kjo qe një vdekje për së gjalli.

4.2 GJUHA DHE RËNDËSIA E KËSAJ VEPRE NË LETËRSINË SHQIPTARE

“Ismail Kadare në letërsinë shqiptare njihet si ambasador i kulturës shqiptare” (“Prilli i thyer”, 2022). *“Ismail Kadare është shkrimtari, poeti, prozatori bashkëkohor e përfaqësuesi më i shquar i letërsisë shqipe, dhe në aspektin e artit letrar, ambasador i shqiptarëve në botë që disa herë është nominuar për çmimin “Nobel” për letërsi”* (“Prilli i thyer”, 2022).

Me këtë vepër autori ishte i lidhur emocionalisht sepse aty përshkroi temat të cilat ishin të ndejshme. Këto tradita të cilat janë zhvilluar sipas kanunit të Lekë Dugagjinit. Traditat zakonore të cilat i përshkruan autori në këtë vepër ishin më të përhapura në Shqipërinë e Veriut.

“Duke lexuar “Prillin e thyer” kuptohet lehtësisht përse dhe me çfarë force Ismail Kadare është pasionuar për tragjedinë dhe për dy përfaqësuesit më të shquar të saj, Shekspirin dhe Eskilin” (cb.al, 2022) *“Miku, besa dhe gjakmarrja janë rrotat e mekanizmit të tragjedisë antike, dhe të futesh në mekanizmin e tyre është të shikosh mundësinë e tragjedisë”* (dukagjinibooks, 2022).

“Ismail Kadareja është autor i shumë veprave në poezi e në prozë, lauerat i shumë çmimeve kombëtare, kandidat i çmimit Nobel për shumë vite me rradhë, anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Anëtar i Akademisë Franceze të Shkencave Morale.” (koha, 2022).

Në këtë vepër autori shtjellon temat që kanë qenë shumë të njohura më herët te shqiptarët siç janë besa, gjakëmarrja dhe nderi. Këto tema që i ka shtjelluar autori në këtë vepër te populli shqiptarë janë ruajtur me fanatizëm sidomos në vitet 30 –ta. Tema mjaft të prekura, por që popujtë tjera nuk i kanë pasur shumë të njohura si populli jonë. Vepra “Prilli i thyer” i shkrimtarit Ismail Kadare, jo vetëm në letërsinë shqiptare, por edhe në atë të huaj është shumë i njohur. Përveç temave kryesore që i ka përmendur autori aty ai përmend edhe rëndësin e librit të njohur te populli shqiptarë që është “Kanuni”. Pra, në bazë të rregullave kanunore është shkruar kjo vepër letrare që është mjaft e njohur. Ky është i vetmi libër që është i shkruar në bazë të kanunit apo kodit kanunor nga ky autor. Vetë titulli i veprës “Prilli i thyer” tregon për një rregull kanunor që deshe apo nuk deshe duhet mbajtur , ishte besa 30 ditëshe.

“Kadare është shkrimtari që i ktheu mitet legjendare në realitet, shkrimtari që bëri histori prej prehistories; pa rënë në kundërthënie me vetveten dhe gjykimin modern, ai arsyetoi

estetikisht në mënyrë të përkorë dhe për kohën absolute” (fv.al, 2022)“Në Shqipërinë e ndodhur në udhëkryq vepra e Kadaresë ka qenë dhe mbetet një shpresë apo agur i bardhë për të” (koha.net, 2022).

Gjuha të cilën autori e përdor në këtë vepër është mjaft e pasur, sipas rregullave gramatikore. Kjo vepër është e përdorur në disa gjuhë, poashtu është e bërë edhe film në Shqipëri, Francë dhe Brazil.

“Vepra e Ismail Kadares është e përkthyer në 32 gjuhë të huaja duke arritu kështu record të përhapjes në tërë botën e qytetëruar” (letersia, 2022).

Kjo vepër ka rëndësinë e vet në letërsinë shqiptare sepse posa e përmend shkrimtarin të shkon mendja menjëherë të kjo vepër shumë e njohur që ka lidhje me kanunin. Rëndësi është sepse përveç kësaj edhe në letërsinë e huaj njihet shumë.

“Vepra është përkthyer në anglisht me titullin Broken April (Nju Jork 1990), frëngjisht (Paris 1982), greqisht (Athinë 1988), spanjisht (Barcelonë 1990), polonisht (Varshavë 1988), gjermanisht (Zalcsburg 1989), bullgarisht (Sofje 1989). (R.Elsie, 1997:f. 394)” (SHEHABI-VESELI & MALOTA, 2022). “Kujtojmë se vepra është bërë film, me titullin “Të paftuarit” (1985) me regji të Kujtim Cashkos, nën lojën e aktorëve më të mirë shqiptarë si Reshat Arbana, Vangjush Furxhiu, Rajmonda Buklu, Piro Qirjo, Guilem Radoja, Mario Ashiku etj.” (SHEHABI-VESELI & MALOTA, 2022).

KAPITULLI I PESTË

5. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Kadareja, njohës i mirë i së kaluarës së popullit shqiptar, ngjarjen në roman e ka vendosur në veri të Shqipërisë, pikërisht në Krahinën e Mirditës, një rrafsh i ndarë nga pjesa tjetër e vendit, ku Kanuni i Lekë Dukagjinit lunate rolin e kushtetutës së një shteti.

Temën që trajton autori në veprën e tij, është ajo e gjakmarrjes dhe kjo pasqyrohet nëpërmjet personazhit të Gjorgut, i cili duhet të marrë gjakun e vëllait dhe martesën e bashkëshortëve nga kryeqyteti, të cilët vendin për ta kaluar muajin e parë të mjaltit zgjedhin Rrafshin (veriu e Shqipërisë).

Ky itenirar i udhëtimit të tyre në Rrafsh, bëhet pikërisht se shkrimtari Vorpsi donte t'ia tregonte gruas së tij, Dianës, se si funksionon kanuni ende në këto pjesë.

Besa dhe gjakmarrja janë temat kryesore të romanit ku ka dhe elemente nga kanuni në romanin “Prilli i thyer”, autori jep një përshkrim të traditave shqiptare.

Sa i përket zhvillimit të ngjarjes në roman, ajo zgjat në periudhën tridhjetë ditëshe nga 17 marsi deri 17 prill. Po kjo periudhë kohore shënon dhe udhëtimin e çiftit të sapomartuar në Rrafsh.

Gjatë kësaj periudhe tridhjetëditore, në brendi të romanit kemi të përshkruar rregulla kanunore të jetës shqiptare që nga momenti kur Gjorgu mori hakun e të vëllait, duke e vrarë Zefin e Kryeqyqëve e deri në momentin kur ai (Gjorgu) u vra nga Kryeqyqet.

Edhe pse autori na jep një përshkrim të bukur të natyrës shqiptare, me bisedën dhe sytë e çiftit Vorpsi, me male hijerëndë ku rrinë vetëm shqiponjat, me përroje e burime uji, prapëseprapë nuk janë të bollshme, në krahasim me jetën e zymtë e të varfër që bëjnë njerëzit

që jetojnë aty. Me përshkrimin që Kadareja “*i bënte Kullës së Oroshit, po edhe pajtimin të gjaqeve dhe të ndarjes së pronave në mes fshatrave nga personazhi i Binak Alisë me ndimësit e tij, ai i bënte një kritikë sistemit monist në Shqipëri, i cili edhe pas shtrirjes së tij në gjithë*” (Voltaire, 2022) , territorin shqiptar, këtu ende nuk kishte depërtuar. Me këtë autori ka aluduar sipas mendimit tim, se kushtetuta dhe ligjet e shtetit shqiptar nuk përfillehin fare në Rrafsh dhe i vetmi ligj që merrej me gjakmarrjen ishte Kanuni i Lekë Dukagjinit.

Fillimi i romanit, personazhi Gjorgu pati dyshimet e tij se a duhej a po nuk duhej të marrë gjakun e vëllait edhe kjo sipas kanunit ishte pjesa ma e turpshme e të menduarit për një banor të Rrafshit, familja e të cilit ishte në gjakmarrje.

Gjorgu edhe pse kishte mendime të ndryshme për hakmarrjen, mendonte të e merrte apo të mos e merrte gjakun, edhe pse ishte i detyruar të e marrë gjakmarrjen se e kërkonte zakoni kanunor që ishte trashëguar nga çdo brez në vendin e tij. Edhe pse dikush vritet nga dorasi, respektohet vdekja por edhe i vrari pa e gjymtuar atë, apo grabitur, por i vihet pushka te koka dhe rregullohet. Një veprim i tillë, nuk besoj se është te popujt e tjerë. (autori kryen raporte intertekstuale në mënyrë të vetëdijshme me Kanunin, për ta përjetësuar një veprim unik që është i pranishëm vetëm te populli shqiptar.)

“*Sipas Mehmet Elezit, në romanin “ Prilli i thyer”, Kadareja përcjell artistikisht madhështinë e mrrolët të botës së Kanunit, fuqive dhe tragjizmit pa fund, për të cilin thua se vetëm atë male me kreshta të rënda e thepa qiellorë, ku thërmohen e vdesin rrufetë, mund ta durojnë e ta mbajnë në shpatulla dhe vetëm atëherë atyre u ka hije tërë ajo peshë mbi jetën dhe vdekjen bashkë*” (gazetashqiptare, 2022).

“*Sipas kritikut letrar, Ali Aliut, në romanin Prilli i thyer, Kadare ballafaqohet me refleksat e brendshme të shqiptarit, në mbrojtje të identitetit të tij dhe pasojat që dalin nga fenomeni i gjakmarrjes*” (Miti Ballkanik, 2022).

Siç dihet, Ismail Kadareja është protagonist i jetës kulturore dhe letrare në Shqipëri. Krijimtaria letrare është e lidhur me vendin e tij, pra Shqipërinë apo kombin shqiptar. Në veprën “Prilli i thyer” autori që në fillim tregon për gjakmarrjen që duhet marrë. Nga kush? Nga një djalosh i ri i cili është quajtur Gjorg dhe rinia e tij tani më ishte kthyer në tjetër kahje.

Në këtë vepër letrare autori tregon gjerë e gjatë ngjarjen e marrjes së gjakun në Rrafsh. Aty autori përshkruan se si bëhet vrasja, nga kush, për kënd, sa vrasje kanë ndodh me ato familje e shumë tema tjera.

Baza themelore e kësaj vepre është gjakëmarrja e cila ka qenë shumë e fuqishme në Rrafsh apo ndryshe siç njihet pjesa veriore e Shqipërisë.

Vrasja kishte ndodhur nga Gjorgu, nuk kishte ndodhur me vullnetin e tij, ai këtë vrasje e kishte bërë sa për të larë gjakun e të vëllait. Për Gjorgun qetësia shpirtërore nuk mund të gjendet sepse të vrasësh një njeriu nuk është e thjeshtë. Jeta e Gjorgut mori një kahje ndryshe nga ajo se çfarë ai kishte ëndërruar më herët për jetën e vet. Në jetën e tij nuk pati më të mira, por vetëm ngjarje dhe ndodhi.

Në këtë roman përveç vdekjes, vrasjes autori shkruan për një dashuri të paarrirë, për kullat, doket dhe zakonet kanunore në Rrafsh.

Autori në romanin “Prilli i thyer” ka bërë një ndërlidhje me kanunin, ku në bazë të kanunit është bërë vrasje, besa dhe gjakmarrja.

Me romanin “Prilli i thyer”, autori Ismail Kadare e bëri që Shqipëria të jetë e pranishme në arenën ndërkombëtare, me kulturën dhe historinë e saj.

Nëpërmjet rrëfimit të ngjarjeve që shtjellon autori në roman, në mënyrë perfekte është gërshetuar me ligjet kanunore që mbretëronin në Rrafsh, e kryesisht në pjesën veriore të Shqipërisë.

Dianës, vajza që është një nga personazhet kryesore të veprës, ato që Besiani i rrëfen, burri i saj gjatë udhëtimit rreth kanunit dhe mënyrës së jetesës së malësorëve i dukej si në ëndërr, por kur ajo zbret në Rrafsh, aty ballafaqohet me realitetin e hidhur, ku Kanuni ishte udhërrëfyesi kryesor i jetës së vështirë të banorëve.

Autori gjatë rrëfimit të udhëtimit të familjes Vorpsi në Rrafsh, na njeh dhe me normat zakonore të malësorëve, ku vepronte Kanuni.

Në këtë vepër, autori na njeh me tri shtyllat kryesore të Kanunit që ishin; gjakmarrja, besa, nderi.

Një nga virtytet më të larta ishte besa, nëpërmjet së cilës gërshetohen dhe gjakmarrja dhe nderi.

Bibliografia

- (n.d.). Retrieved from fjalor i gjuhës shqipe: <https://fjalorthi.com/paku>
- (n.d.). Retrieved from Shtjefën Gjeçovi: <https://albania.123.st/t4275-shtjefen-gjecovi-1874-1929>
- (2021, Dhjetor 25). Retrieved from Kanuni I L. D.:
<https://sq.yourliterary.com/vepra/Analize+letrare/Kanuni+i+Leke+Dukagjinit+/6944>
- (2021, Dhjetor 29). Retrieved from Kanuni I L. D.: <https://www.mekulipress.com/kanuni-i-leke-dukagjinit-kodi-i-se-drejtës-zakonore-shqiptare/>
- (2022, Mars 16). Retrieved from Damet: <https://forumi.net/threads/kanuni-i-lek%C3%AB-dukagjinit-puk%C3%AB.1230/page-3>
- (2022, Mars 16). Retrieved from Arena dardane:
<https://www.facebook.com/ArenaDardane/photos/besa-shqiptare-besa-bes%C3%AB-bes%C3%ABn-ta-kam-dhan%C3%AB-p%C3%ABr-liri-jet%C3%ABn-du-me-dhan%C3%AB-k%C3%ABnga-shk/3929843733723655/>
- (2022, Mars 16). Retrieved from Bibla:
https://books.google.rs/books?id=EbUrDwAAQBAJ&pg=PA92&lpg=PA92&dq=se+gruaja+kurr%C3%AB+nuk+bie+n%C3%AB+gjak&source=bl&ots=Hq1Asoh_oN&sig=ACfU3U3bsYZUB0177ioBvDbrRWJ3kNrvw&hl=sq&redir_esc=y#v=onepage&q=se%20gruaja%20kurr%C3%AB%20nuk%20bie%20n%C3%AB%20gjak
- (2022, Mars 16). Retrieved from Kuptimi i fjalës gjeri: <https://fjalorthi.com/gjeri>
- (2022, Janar 15). Retrieved from Vepra e Kadaresë: https://liberale.al/vepra-e-kadarese-ose-shtegu-i-kerkimit-te-universales-brenda-individit/?fbclid=IwAR1OcvATr_AaZaDcJUMV72f23du80DLqZghPtTxv-N7sji-J-SlhDPJvqro
- (2022, Mars 16). Retrieved from Intert. i "Oh": <http://redaktori.net/?p=12722>
- (2022, Mars 16). Retrieved from Rikthimi i mitit në v. e K.:
<https://dokumen.tips/documents/doktoratura-viola-isufaj-fakulteti-i-histori-filologjise-departamenti-i-letersisepdf.html>
- (2022, Mars 16). Retrieved from Mbi karakterizimin: <https://goaravetisyan.ru/sq/soobshchenie-na-temu-silnaya-lichnost-lenina-lenin-kak-harizmatichnaya-lichnost/>

- (2022, Mars 16). Retrieved from TRADITA SI INTERTEKST :
<https://eprints.unite.edu.mk/824/1/ALBANOLOGJIA%2015-16%20-FINAL-147-155.pdf>
- (2022, Mars 16). Retrieved from GJAMA E BURRAVE: <https://rrenjettona.al/wp-content/uploads/2019/01/Gjama-e-burrave-etnokulture.pdf>
- (2022, Mars 16). Retrieved from L. e shqiponjave:
<https://m.facebook.com/427267964067135/photos/a.427346944059237.1073741828.427267964067135/592703084190288/>
- (2022, Mars 16). Retrieved from M. e shenjtë e sh.: <https://ina-online.net/mikpritja-e-shenjte-e-shqiptareve/>
- (2022, Janar 16). Retrieved from JETA P. V. NGA VDEKJA:
<http://mozaik24.blogspot.com/2011/03/jeta-permes-veshtrimit-nga-vdekja.html>
- (2022, Janar 16). Retrieved from Gj. i B. nëpër ravën e sh.: https://shqiptarja.com/lajm/prilli-i-thyergjorgu-i-berishajve-neper-raven-e-shpagimit?fbclid=IwAR0eABbB_MCtpcgQRQM17Wz5HGYkpQubcocZQDNE6udhEHJE9k9jp7s9Ck
- (2022, Janar 16). Retrieved from Ç'është ekzistencializmi : <https://sq.eferrit.com/cfare-eshte-ekzistencializmi-historia-ekzistuese-dhe-mendimi/>
- (2022, Mars 17). Retrieved from Jeta dhe vepra e I. K.:
<https://sites.google.com/site/jetadheveprat12345/>
- (2022, Mars 20). Retrieved from Ismail Kadare: <https://fjalorthi.com/vertetuar>
- (2022, Mars 20). Retrieved from I kadare: <https://zh-cn.facebook.com/dosja.alb/posts/sot-ismail-kadare-feston-85-vjetorin-e-lindjes/1327609290933540/>
- (2022, Mars 20). Retrieved from fjalori: <https://fjalorthi.com/mysafir>
- (2022, Mars 16). Retrieved from L.D. K.: <https://fv.al/t/lek-dukagjini-dhe-kanuni-i-tij.444/>
- (2022, Mars 20). Retrieved from L.D.dhe K.: <https://fv.al/t/lek-dukagjini-dhe-kanuni-i-tij.444/>
- (2022, Mars 20). Retrieved from Besa: <https://foldrejt.com/besa-te-shqiptaret-perberesi-kyc-i-edukates-popullore/>
- (2022, Mars 20). Retrieved from I.K.:
https://m.facebook.com/ismailkadare1936/photos/a.192086490886410/192086494219743/?type=3&locale2=sq_AL
- (2022, Mars 20). Retrieved from Q. I.: <https://www.drita-islame.org/online/rijadu-salihin/>
- (2022, Mars 20). Retrieved from Fat :
<https://www.facebook.com/groups/a.pipa.artan/posts/3136292176474185/>
- (2022, Mars 22). Retrieved from Voltaire: <https://sq.wikipedia.org/wiki/Voltaire>
- (2022, Mars 28). Retrieved from Ismail Kadare: <https://es-la.facebook.com/cercizloloci/photos/ismail-kadare-komandant-i-legjionit-t%C3%AB-nderit-n%C3%AB-franc%C3%AB5-janar-2016shkrimtari-i-/1111608448912677/>
- (2022, Mars 28). Retrieved from takim: <https://spend.miakilarxalibe.tk/>

- (2022, Mars 28). Retrieved from Gjeniu: <http://shtypi.net/gjeniu-i-letrave-shqipe-feston-86-vjetorine-lindjes/>
- (2022, Mars 28). Retrieved from Antoena: <https://sq.wikipedia.org/wiki/P%C3%ABrdoruesi:Antoena.p>
- (2022, Mars 29). Retrieved from Gjirokastra: <https://m.facebook.com/GjirokastraUnike/photos/a.137671826306171/818181498255197/?type=3>
- (2022, Mars 29). Retrieved from I.K.: <http://www.ekonomia-ks.com/sq/opinion/ismail-kadare-ma-i-fuqishem-ne-paris-per-ceshtjen-kombetare>
- (2022, Mars 29). Retrieved from wikipedia: https://sq.wikipedia.org/wiki/Ismail_Kadare
- (2022, Mars 29). Retrieved from Ese: <https://www.facebook.com/ese.dhe.projekte/photos/-prilli-i-thyer-citime-nga-vepra1-njeriu-q%C3%AB-duhej-t%C3%AB-vdiste-2-ti-pushk-e-pafsh-e/2061851250759176/>
- (2022, Janar 15). Retrieved from Vepra e Kadaresë: <https://www.gazetaexpress.com/vepra-e-kadarese-shtegu-i-kerkimit-te-universales-brenda-individit/>
- (2022, Janar 29). Retrieved from “Prilli i thyer”: <https://portalb.mk/209332-prilli-i-thyer-veshtrimi-i-jetes-nga-syri-i-vdekjes/>
- (2022, Mars 29). Retrieved from pasqyra: <https://cbc.al/prilli-i-thyer-pasqyre-e-kontraditave-sociale/>
- (2022, Mars 29). Retrieved from Miti b.: <https://www.facebook.com/444479355625593/photos/a.525049097568618.1073741828.444479355625593/777441915662667/>
- (2022, Mars 29). Retrieved from f gjokaj: <https://issuu.com/fgjokaj/docs/koha-749>
- (2022, Mars 29). Retrieved from kanuni: <https://lenagarments.com/bpzwea/kanuni-i-lek%C3%AB-dukagjinit>
- (2022, Mars 29). Retrieved from p. e normave: <https://www.facebook.com/historishqiptare1/photos/kanuni-i-lek%C3%AB-dukagjinitkanuni-i-lek%C3%AB-dukagjinit-%C3%ABsht%C3%AB-p%C3%ABrmbledhje-e-normave-dhe/2112638858960015/>
- (2022, Mars 29). Retrieved from vepra: <https://sq.yourliterary.com/vepra.php?lloji=Analize+letrare&id=6944>
- (2022, Mars 29). Retrieved from një popullë: <https://rajonipress.com/shqiptaret-nuk-jane-nje-popull-inferior/>
- (2022, Mars 29). Retrieved from pdf: https://www.researchgate.net/profile/Islam_Qerimi/publication/330524190_Social_Organization_and_Self-Government_of_Albanians_according_to_the_Costumary_Law/links/5c5fff8ea6fdccb608b47673/Social-Organization-and-Self-Government-of-Albanians-according-to-th
- (2022, Mars 29). Retrieved from Kanuni: <https://sq.wikipedia.org/wiki/Kanuni>
- (2022, Mars 2). Retrieved from Kodi: <https://www.mekulipress.com/kanuni-i-leke-dukagjinit-kodi-i-se-drejtes-zakonore-shqiptare/>

- (2022, Mars 29). Retrieved from Lutfi A.: <https://alb-spirit.com/2022/03/16/lutfi-alia-kanuni-kodi-se-drejtes-zakonore-shqiptare-4/>
- (2022, Mars 29). Retrieved from kodi: <https://www.mekulipress.com/kanuni-i-leke-dukagjinit-kodi-i-se-drejtes-zakonore-shqiptare/>
- (2022, Mars 29). Retrieved from p. i thyer: <https://vdocuments.net/universiteti-i-gjakovs-aoefehmi-agania-prilli-i-thyer-ismail-kadare-kandidati.html>
- (2022, Mars 29). Retrieved from f. nderi: <https://fjalorthi.com/nderi>
- (2022, Mars 29). Retrieved from suplementi: <https://telegraf.al/suplement/suplementi-pena-ismail-kadare-romani-prilli-i-thyer-frymezim-nga-kanuni-i-leke-dukagjinit/>
- (2022, Mars 29). Retrieved from Skederbeu: <https://www.kultplus.com/lajme/skenderbeu-dhe-historia-e-tij-si-nje-akademi/>
- (2022, Mars 29). Retrieved from Jeta p. v. nga vdekja:
<https://www.facebook.com/OnufriBooks/photos/agim-ba%C3%A7ip%C3%ABrse-e-soll%C3%ABn-doruntin%C3%ABnp%C3%ABrsiatje-antropologji-sociologjikep%C3%ABr-romanet/810340349018489/>
- (2022, Mars 29). Retrieved from P. i Th.: <https://vynnlife.com/prilli-i-thyer-gjorgu-i-berishajve-neper-raven-e-shpagimit/>
- (2022, Mars 29). Retrieved from suplementi: <https://telegraf.al/suplement/suplementi-pena-ismail-kadare-romani-prilli-i-thyer-frymezim-nga-kanuni-i-leke-dukagjinit/>
- (2022, Mars 29). Retrieved from fragmenti: <http://www.arsalbanica.mk/fragment-nga-romani-prilli-i-thyer-nga-ismail-kadare/>
- (2022, Mars 29). Retrieved from fragmenti: <http://www.arsalbanica.mk/fragment-nga-romani-prilli-i-thyer-nga-ismail-kadare/>
- (2022, Mars 29). Retrieved from f. ecje: <https://fjalorthi.com/ecje>
- (2022, Mars 29). Retrieved from F. ndryshk: <https://fjalorthi.com/ndryshk>
- (2022, Mars 29). Retrieved from F. Tub: <https://fjalorthi.com/tub%C3%AB>
- (2022, Mars 29). Retrieved from Jeta:
https://m.facebook.com/ismailkadare1936/photos/a.192086490886410/192086494219743/?type=3&locale2=sq_AL
- (2022, Mars 29). Retrieved from F. gjeri: <https://fjalorthi.com/gjeri>
- (2022, Mars 29). Retrieved from gramhir: <https://gramhir.com/explore-hashtag/prilliithyer>
- (2022, Mars 29). Retrieved from ese: <https://zh-cn.facebook.com/ese.dhe.projekte/posts/1793179544293016/>
- (2022, Mars 29). Retrieved from academia:
https://www.academia.edu/5657249/Measurement_of_inclusive_jet_and_dijet_cross_sections_in_proton_proton_collisions_at_7_TeV_centre_of_mass_energy_with_the_ATLAS_detector
- (2022, Mars 29). Retrieved from idituri: <https://www.idituri.com/gjakmarrja-plage-e-hershme-e-shoqerise-shqiptare/>

- (2022, Janar 15). Retrieved from Tryezë e rrumbullakët:
<https://www.gov.uk/government/speeches/the-blood-feud-phenomenon.sq>
- (2022, Mars 29). Retrieved from yumpu:
<https://www.yumpu.com/xx/document/view/38242652/doktoratura-lutfije-cota-fakulteti-i-gjuheve-te-huaja-departamenti-i->
- (2022, Mars 29). Retrieved from F. ab: <https://fjalorthi.com/v%C3%ABrtetoj>
- (2022, Mars 29). Retrieved from f. Gjeri: <https://fjalorthi.com/gjeri>
- (2022, Mars 29). Retrieved from cb.al: <https://cbc.al/prilli-i-thyer-pasqyre-e-kontraditave-sociale/>
- (2022, Mars 29). Retrieved from dukagjinibooks: <https://dukagjinibooks.com/en/books/17270>
- (2022, Mars 29). Retrieved from koha: <https://www.koha.net/?id=&l=95721>
- (2022, Mars 29). Retrieved from fv.al: <https://fv.al/t/ismail-kadare.715/>
- (2022, Mars 29). Retrieved from koha.net: <https://www.koha.net/?id=4&l=42548>
- (2022, Mars 29). Retrieved from letersia:
http://www.lettersia.fajtori.com/Letersi/Moderne/Ismail_Kadare/
- (2022, Mars 29). Retrieved from gazetashqiptare: <http://gazetashqiptare.al/2018/01/28/kanuni-dhe-romani-kadarese-prilli-thyer/>
- (2022, Mars 29). Retrieved from Miti Ballkanik:
<https://www.facebook.com/444479355625593/photos/a.525049097568618.1073741828.444479355625593/777441915662667/>
- ALIU, A. (2022, Janar 26). Retrieved from MITI BALLKANIK TE KADAREJA:
<https://www.facebook.com/OnufriBooks/photos/miti-ballkanik-te-kadarejanga-ali-aliu%C3%ABsht%C3%AB-nj%C3%AB-episod-d%C3%ABshmi-nga-vet%C3%AB-ismail-ka/797162003669657>
- autorësh, G. (2005). *Gjuha shqipe she letërsia 4*. Tiranë-Tetovë-Prishtinë: Albas.
- Baçi, A. (2022, Mars 29). Retrieved from fb: <https://www.facebook.com/OnufriBooks/photos/agim-ba%C3%A7ip%C3%ABrse-e-soll%C3%ABn-doruntin%C3%ABnp%C3%ABrsiatje-antropologji-sociologjik%C3%ABr-romanet/810340349018489/>
- Elezi, M. (2022, Janar 25). Retrieved from Kanuni dhe “Prilli i thyer” i Kadare: https://flashqip.ca/kulture/5790-kanuni-dhe-prilli-i-thyer-i-kadarese-nga-mehmet-elezi?fbclid=IwAR3sgQ2Yq0P4gckszFi_xZxGq6-WwBOW81VSSg4ln9a1ccKF0un40jQ10Co
- Gjeçovi, S. (a.d.). *Kanuni I Lekë Dukagjinit*. kuvendi.
- GJOKA, F. (2021, Dhjetor 10). Retrieved from Gjakmarrja, plagë e hershme e shoqërisë shqiptare: https://www.idituri.com/gjakmarrja-plage-e-hershme-e-shoqerise-shqiptare/?fbclid=IwAR3dcCUpDSMDPKFuieMG_T25JVNLOdfxKcsq2rBvLr5fuzAG6itOZE7mCBw
- Isufaj, V. (2022, Mars 29). Retrieved from Doktoratura: <https://idoc.pub/documents/doktoratura-viola-isufaj-fakulteti-i-histori-filologjise-departamenti-i-lettersisepdf-34wmorygv8l7>
- Kadare, I. (2022, Janar 5). Gjetur në https://sq.wikipedia.org/wiki/Ismail_Kadare

- Kadare, I. (2009). *Vepra-v.11-Prilli i thyer*. Tiranë: Onufri.
- Kadare, I. (2022, Janar 8). Retrieved from https://bukinist.al/sq/366_ismail-kadare
- Kadare, I. (2022, Janar 9). Retrieved from f. e autorit:
: https://www.librat.al/web/Ismail_Kadare_151_1.php?stp=prfl&aid=440
- Kadare, I. (2022, Janar 9). Retrieved from faqja e autorit:
: https://www.librat.al/web/Ismail_Kadare_151_1.php?stp=prfl&aid=440
- kuptimi i fjalës së vërtetuar*. (2022, Mars 16). Retrieved from <https://fjalorthi.com/vertetuar>
- Merika, R. (2022, Mars 29). Retrieved from pdf: https://uet.edu.al/wp-content/uploads/2021/12/Rexhina_Merlika.pdf
- Piegay-Gros, N. (2011). *Hyrje në intertekstualitet*. Prishtinë : “Parnas”.
- Shehabi, M. (2021). *slidet e ligjëratave*. Tetovë.
- SHEHABI-VESELI, M., & MALOTA, A. (2022, Janar 30). Retrieved from TRADITA SI INTERTEKST :
<https://eprints.unite.edu.mk/824/1/ALBANOLOGJIA%2015-16%20-FINAL-147-155.pdf>

Deklaratë

Unë, Luljeta Adili-Çeliku, docente në Universitetin “Shën Qirili dhe Metodi,,- Shkup, Katedra e Gjuhës dhe Letërsisë Shqiptare, deklaroj se e kam lektuar temën e magjistraturës së kandidatës Egzona Mustafa me titull: **KANUNI SI INTERTEKST NË ROMANIN “PRILLI I THYER”**, nga faqja 1-63 dhe për të njejtën mbaj përgjegjësi morale dhe juridike.

Luljeta Adili-Çeliku

Shkup, 2022

